



INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVËS

Zehrie Plakolli
Mevlude Aliu - Gashi

**BASHKËPUNIMI EDUKATOR - PRIND
NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE
TË KOSOVËS**

Prishtinë, 2016



Zehrie Plakolli
Mevlude Aliu - Gashi

**BASHKËPUNIMI EDUKATORE - PRIND NË
INSTITUCIONET PARASHKOLLORE
TË KOSOVËS**

Prishtinë, 2016

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Për botuesin:

Labëri Luzha

Autorë:

Zehrie Plakolli

Mevlude Aliu-Gashi

Recensent:

Ganimete Kulinxha

Këshilli Shkencor i IPK-së:

Prof.Dr. Hajrullah Koliqi

Prof.Dr. Naser Zabeli

Prof.Dr. Hatixhe Ismajli

Prof.Dr. Linda Grapci

Mr.Sc. Blerim Saqipi

Korrektues gjuhësor

Bedri Zyberaj

Përgatitja teknike

Skender Mekolli

Përmbajtja

Abstrakt.....	5
Hyrje.....	10
Përkufizimi i nocioneve bazë.....	11
I. QASJA TEORIKE.....	15
1.1. Edukatorja si faktor i edukimit të fëmijëve dhe qasja e saj profesionale ndaj bashkëpunimit me prindër.....	15
1.2 Prindi si faktor i edukimit të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme dhe si bashkëpunëtor i edukatores.....	19
1.3 Qasja profesionale e institucionit parashkollor, ndaj bashkëpunimit me prindër.....	24
II-METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	27
2.1. Rëndësia e hulumtimit.....	27
2.2. Objekti i hulumtimit.....	28
2.3. Qëllimi dhe detyrat e hulumtimit:.....	29
2.4. Pyetjet e hulumtimit.....	29
2.5. Hipoteza e hulumtimit.....	30
2.6. Popullacioni dhe përzgjedhja e mostrës.....	30
2.7. Instrumentet e përdorura:.....	31
2.8. Dinamika e hulumtimit:.....	31
III. REZULTATET E HULUMTIMIT-ANALIZA DHE INTERPRETIMI.....	33
3.1. Të dhënat nga edukatoret.....	33
3.2. Reflektimi i prindërve lidhur me bashkëpunimin edukator – prind.....	51

IV. KONKLUSIONE, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME (të bazuara në rezultatet e dala nga terreni):	60
4.1. Rekomandime të përgjithshme – për MASHT-in	61
4.2. Rekomandim për Fakultetin e Edukimit	63
4.3. Rekomandimet për IP.....	64
4.4. Rekomandime - këshilla për edukatorë:.....	65
4.5. Rekomandime-këshilla për prindër	67
Burimet.....	70
V- SHTOJCA;	72

Abstrakt

Edukimi i mirëfilltë i gjeneratës së re, në çdo shoqëri të organizuar, obligon të gjithë faktorët e edukimit (familjen, komunitetin dhe institucionet kompetente) për një mobilizim, lidhur me këtë çështje. Një proces i tillë si mjaft kompleks dhe delikat, është edhe edukimi në fëmijërinë e hershme. Në kuadër të këtij niveli të edukimit, bashkëpunimi edukatore-prind si pjesë e obligueshme e punës së institucioneve parashkollore, është çështje e një rëndësie të veçantë.

Duke u bazuar në shqyrtime të literaturës profesionale, shihet se problemi në fjalë, është mjaft i trajtuar në nivel kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Mirëpo, studime konkrete, rreth mënyrës së realizimit si dhe aspekteve përmes të të cilave realizohet ky bashkëpunim në praktikën e punës së institucioneve parashkollore në mjedisin tonë kosovar, duket të mos ketë pasur deri tani. Kështuqë, përmes këtij studimi, është bërë përpjekje, që në bazë të një analize empirike me të dhëna faktike, të definohen nevojat dhe mundësitë e një bashkëpunimi më profesional dhe më efikas për zhvillimin e fëmijëve.

Me qëllim të strukturimit të përmbajtjes në formë adekuatë, punimi është strukturuar në pesë kapituj, të cilët përmbajnë hyrjen, sqarimin e nocioneve, fjalët kyçe të studimit, kontekstin teorik, qasjen metodologjike të problemit studimor, të dhënat empirike të dala nga reflektimi i edukatoreve dhe prindërve lidhur me bashkëpunimin, deri tek konkludimet, rekomandimet dhe përfundimi. Qasja metodologjike, reflekton lidhur me rolin dhe rëndësinë e hulumtimit, qëllimin e studimit, objektivat e veçanta dhe të përgjithshme, hipotezën e hulumtimit, mostrën, metodat dhe teknikat e hulumtimit. Pjesa e qasjes teorike, është pjesa

kryesore ku i jepet sqarim, analizim dhe reflektim i mendimeve të mëhershme, për bashkëpunimin efektiv edukatore-prind dhe mënyrën e këtij bashkëpunimi. Në kuadër të këtij kapitulli, trajtohet në mënyrë të veçantë, qasja profesionale e edukatores ndaj prindit, pastaj gatishmëria dhe qasja e prindit ndaj bashkëpunimit me edukatoren dhe institucionin parashkollor. Në kuadër të tij, kemi edhe një lloj historiku të shkurtër, të qasjes pedagogjike ndaj rëndësisë së familjes dhe prindit, në edukimin dhe trajtimin e duhur të fëmijës. Ky kapitull po ashtu trajton edhe rëndësinë e këtij bashkëpunimi, i cili në fakt është edhe një lloj përcaktuesi i zhvillimit cilësor të fëmijës dhe i suksesit të punës së edukatores e institucionit parashkollor në përgjithësi.

Pjesa e paraqitjes së të dhënave statistikore nga terreni, përmban pasqyrimin e mendimeve, këndvështrimeve dhe të fakteve që ofrojnë edukatorët rreth bashkëpunimit që ato e realizojnë me prindër gjatë punës së tyre me fëmijët. Këto janë shprehur përmes përgjigjeve që kanë dhënë ato, nga pyetjet e ofruara në pyetësor, të cilin e kemi përdorur si instrument hulumtimi. Në të njëjtën mënyrë kemi marrë edhe opinionet e prindërve lidhur me rëndësinë e bashkëpunimit me edukatoren, institucionin parashkollor dhe efikasitetin e tij për zhvillimin e fëmijëve të tyre.

Pjesa e përfundimit dhe konkluzioneve, është edhe pjesa qëllimore e kësaj studimi përpjekja e të cilit ishte, sigurimi i të dhënave dhe informacioneve reale për mënyrat e bashkëpunimit që zbatohen në Institucionet Parashkollore të ne. Kurse pjesa e sugjerimeve dhe rekomandimeve, e ka dalë si rezultat i mangësive që janë identifikuar në terren, gjatë pjesës hulumtuese, të cilat duhet t'i kenë parasysh, ata të cilëve u janë dedikuar. Kështu që, punimi paraqet trajtimin e një segmenti kyç të realizimit të punës në Edukimin Parashkollor, pra,

bashkëpunimin edukatore-prind. Trajtimi i kësaj çështjeje, është bërë nga dy këndvështrime; nga aspekti teorik (duke shfrytëzuar literaturën profesionale, adekuate të fushës), se çfarë dhe si, duhet të jetë ky bashkëpunim, si dhe nga prizmi empirik, duke pasqyruar të dhëna, që flasin për praktikën që zbatohet në terren.

Fjalët kyçe; Edukimi Parashkollor, Institucioni Parashkollor, bashkëpunim, edukatore, prind.

Abstract

This research paper titled "Educator-parent cooperation in preschool institutions of Kosovo" attempts to analyse and study ways of cooperation between educators and parents, aspects of cooperation in realizing work in preschools institutions and the impact of this cooperation on child development and early childhood education.

In order to structure the content properly, the paper is structured in five chapters consisting of introduction, explanation of terms, keyword study, theoretical context and methodological approach to the study problem, empirical data derived from the reflection of educators and parents regarding cooperation, as well as conclusions, recommendations and summary. The methodological approach reflects the purpose of the study, the specific and general objectives, the research hypothesis, the sample and research methods and techniques. The theoretical context is the main part where an explanation, analysis and reflection of previous opinions is provided for effective cooperation and ways of cooperation. This chapter focuses on the professional access of educators to parents and the parents' willingness and approach to cooperation with the educator and the preschool institution. Under this framework, we also have a short background of pedagogy approach to the importance of family and parent education and proper treatment of the child as well as to the importance of this cooperation, which is also a determinant of the successful work of educators and primary institutions in general.

The part presenting statistical data from the field provides a review of opinions, views and facts given by educators concerning their cooperation with parents in their work with children. These are expressed through their responses to the questionnaire that we used as a research instrument. In the same way, we also took into account the opinions of parents on the importance of cooperation with educators-primary institutions and its effectiveness in the development of their children.

The part of conclusions and summary is the essential part of this study, which aimed to provide real data and information on ways of cooperation applied in our preschool institutions. Finally, the part of suggestions and recommendations addresses deficiencies identified during the field research and they must be taken into account by those to whom they are addressed. Thus, this paper addresses a key segment of work in preschool education, namely the parent-educator cooperation. This issue was addressed from two perspectives: theoretical (using relevant literature in the field), focusing on what this cooperation is and how it should be; and empirical, focusing on data that reflect on applied practices in the field.

Key words; *Preschool education, preschool institution, cooperation, educator, parent*

Hyrje

Që bashkëpunimi edukator-prind, është çështje e domosdoshme e cila duhet të realizohet me përkushtim, në kuadër të punës së edukatores dhe të Institucionit Parashkollor, dëshmon dhe obligon edhe „Ligji mbi edukimin parashkollor”, më saktësisht, Ligji Nr. 02/L-52 – 2006. Sipas këtij ligji, janë të përcaktuara në detaje edhe fushat e aspektet, në të cilat duhet të zbatohet bashkëpunimi, si dhe obligimet që ka edukatorja dhe prindi, lidhur me këtë bashkëpunim. Kjo thuhet më konkretisht në nenin e parë, në përkufizimin nr.7: „Pjesëmarrja e prindërve i referohet involvimit të prindërve në aranzhimet e bëra nga institucionet parashkollore, për të ndihmuar dhe kontribuar prindërit në efektivitetin e vendimeve në edukimin e fëmijëve të tyre, aktivitetet të cilat mbështesin plan programin e atyre, të cilët asistojnë në veprimin e institucioneve parashkollore”. Po ashtu, sipas nenit 8 të këtij ligji, ndër detyrat themelore të Institucioneve Parashkollore, detyrë e parë është; „Ndihma për prindërit, në përkujdesjen dhe edukimin e fëmijëve”.

- Ndërkaq neni 11 i Ligjit për Edukimin Parashkollor, i cili shqyrton plan programet parashkollore, më saktësisht pika 11.1, thotë: „Institucionet parashkollore do të shkoqisin plan programet duke i ofruar objektivat, përmbajtjet dhe metodat e punës. Këto publikohen, posaçërisht edhe për prindërit”.

- Bashkëpunimi i Institucionit Parashkollor me prindërit, nuk mbetet pa u potencuar, as te çështja e miratimit të programeve edukativo-arsimore, për fëmijët parashkollor, ku neni 12, pika 3 specifikon se, njëri ndër programet edukative për fëmijë që Institucioni duhet ta ofrojë për miratim, është edhe „Mënyra dhe forma e bashkëpunimit me prindër”

Se sa i rëndësishëm është faktori prind në punën me fëmijë, tregon edhe Neni 29, pika 1 e të njëjtit ligj (për parashkollor), sipas të cilës potencohet që; „Fondi i orëve të punës për edukatorë parashkollor, duhet të përfshijë përgatitjet, planifikimin, realizimin e aktiviteteve edukative, bashkëpunimin me prindërit dhe pjesëmarrjen e tyre, në organizimin e jetës dhe të punës në institucionet parashkollore``.

Meqenëse bashkëpunimi me prindër e lehtëson shumë punën e edukatores dhe stimulon zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës edhe Ligji për Edukimin Parashkollor e obligon institucionin parashkollor dhe edukatoren, që ky bashkëpunim të realizohet në forma e aspekte të ndryshme profesionale. Vëzhgimi dhe hulumtimi që kemi bërë në këto institucione, na shpie deri te konstatimi se praktika e bashkëpunimit edukatore-prind, është larg nga teoria, ose ajo që shkruhet (nëpër dokumente në të cilat bazohet edukimi parashkollor) dhe se ky bashkëpunim, është mjaft formal, jo i hapur, jo përmbytësor dhe me qasje, jo shumë profesionale.

Përkufizimi i nocioneve bazë

Përcaktimi i nocioneve bazë, që kanë të bëjnë me problemin studimor, paraqet një çështje kyçe, e cila orienton semantikisht përmbytjen e punës studimore. Një gjë e tillë është e nevojshme, për shkak të mundësisë që gjatë përdorimit të këtyre nocioneve në përmbytjen e këtij punimi, këtyre termave, mund t'u jepen kuptime të ndryshme dhe jo adekuate. Saktësimi teorik i nocioneve kyçe, të përdorura gjatë mbarështimit të përmbytjes së

këtij punimi, mundëson tejkalimin e paqartësive dhe kuptimin më të thellë të problemit të trajtuar.

Bashkëpunim; Ky nocion, është sinonim i një pune të përbashkët për të kryer një punë apo për të arritur një rezultat.

Bashkëpunimi edukatore-prind; Nënkupton, ndërveprimin mes institucionit parashkollor dhe familjes, gjegjësisht edukatores dhe prindit, në mënyrë të vazhdueshme, përmes alternativave të ndryshme të bashkëpunimit konkret, i cili reflekton direkt, në zhvillimin e fëmijës e njëkohësisht edhe në realizimin e punës më cilësore, të institucionit. Të dy faktorët bashkëpunues kanë detyrat dhe përgjegjësitë e veta edukative e zhvillimore, si dy subjekte kryesore për edukimin dhe zhvillimin e fëmijës.

Edukimi parashkollor: Ky nocion, i referohet edukimit në fëmijërinë e hershme, gjegjësisht edukimit të fëmijëve të moshave 0-6 vjet. (Kjo është, sipas standardeve të edukimit parashkollor në Kosovë, sepse ky nivel edukimi, në shumë vende nënkupton edukimin e moshave, 0-8 vjet).

Qëllimi i shërbimeve të edukimit parashkollor është, që të promovojë zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve, duke i ndihmuar ata, për të marrë qëndrimet dhe kompetencat që do të lehtësojnë suksesin e tyre si nxënës, si individë dhe duke u mundësuar atyre, që të integrohen gradualisht në shoqëri.

Edukatore/e: personi i kualifikuar sipas dispozitave të ligjit mbi arsimin parauniversitar, me përgatitje akademike dhe profesionale, i/e punësuar, për ofrimin e shërbimeve arsimore për fëmijët e moshës 0-6 vjet.

Institucion parashkollor: Objekte apo shtëpi e përshtatur, e cila është e ndërtuar në mënyrë speciale, për të ofruar programe edukative për parashkollorët, të cilat plotësojnë nevojat edukative dhe zhvillimore të fëmijëve, deri në regjistrimin e tyre në shkollën fillore. Këto institucione, ofrojnë shërbime të cilat janë me orar të plotë, gjysmë orari dhe mund të zgjatet orari edhe gjatë shërbimit të mbrëmjes. Është institucion me organizim të veçantë dhe me detyra specifike, konform moshës së fëmijëve.

Prindi: Pa e saktësuar kuptimin e këtij nocioni në aspektin biologjik, potencojmë që fjala prind, në aspektin etik, moral, social, emocional e shpirtëror, nënkupton personin absolutisht më të dashur (në çdo kuptim të mundshëm) për fëmijën, i cili (në kushte e rrethana normale) është në gjendje në çdo situatë dhe moment, të bëj gjithçka për të voglin e vet. Nëse flasim për aspektin e kulturës pedagogjike të prindit, ajo përfitohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përmes thellimit të qëllimshëm të njohurive të kësaj specifike, ndërkaq në mënyrë indirekte, kjo kulturë përfitohet, duke shfrytëzuar dhe duke parë përvoja të prindërve të tjerë me të cilët ai ka komunikim. Prindërit e rinj të shoqërisë tonë, shumica, krijojnë marrëdhënie me fëmijën e vet, jo duke u informuar nga studime dhe analiza shkencore, mjekësore e sociale, për një qasje korrekte e të duhur ndaj fëmijës së tyre, por informohen spontanisht, përmes prindërve, që iu mundësohet t'i shohin përreth vetes dhe duke imituar ata, ndoshta edhe në mënyrë të pavetëdijshme. Kulturën dhe njohuritë për qasje të duhur ndaj fëmijës, prindi mund t'i kultivojë, vetëm duke bërë përpjekje për një edukim dhe përkujdesje të suksesshme ndaj fëmijës. Kjo arrihet, duke u informuar nga literatura të shumta, që janë të dedikuara, për edukimin e prindërve, lidhur me qasjen ndaj fëmijës së vet. Mirëpo „Sipas konstatimeve të disa

sociologëve amerikan, nuk janë gjithmonë të mirë ata prindër, që dinë shumë për zhvillimin fizik, motorik, emotiv dhe intelektual të fëmijës, sepse më të mirë janë ata prindër që kanë personalitet stabil, të integruar dhe të përshtatshëm” (Brada,1995, f. 123)

I. QASJA TEORIKE

1.1. Edukatorja si faktor i edukimit të fëmijëve dhe qasja e saj profesionale ndaj bashkëpunimit me prindër

Rëndësia e pakontestueshme e bashkëpunimit edukator - prind, është konfirmuar edhe me Ligjin për Edukimin Parashkollor, ku ky bashkëpunim, është përcaktuar si një ndër parimet kryesore të këtij niveli të edukimit. Prandaj, funksionimi i këtij komponenti, gjatë realizimit të punës me fëmijët e moshës parashkollore, është obligim i secilit institucion parashkollor në përgjithësi, dhe i secilës edukatore në veçanti. Alternativat e bashkëpunimit me prindër, janë specifike për secilin vend, për secilën shoqëri dhe për secilën kulturë të familjes kurse edukatorja, gjatë praktikës së bashkëpunimit, duhet t'i ketë parasysh këto specifika. Mirëpo, janë edhe disa strategji universale, të komunikimit me fëmijët, dhe të cilat, ndikojnë në krijimin e disa vetive, po ashtu universale, të cilat vlejnë për të gjithë fëmijët e të gjitha shoqërive dhe kulturave. Disa prej tyre mund të jenë edhe ;

- Mbledhje periodike të prindërve në ambientin e kopshtit, ku bashkëbisedohet për temat rreth funksionit dhe programit të kopshtit dhe informatat e përgjithshme për fëmijët.
- Konsultime të shkurtra, të përditshme me edukatoren/in, kur prindërit sjellin ose marrin fëmijët e tyre nga kopshti duke këmbyer informata reciproke rreth fëmijës.
- Takime të posaçme, individuale të prindërve me edukatorin/en (dhe sipas nevojës), ku u jepet mundësia të

dyve, që të japin mendime dhe vlerësime që kanë të bëjnë me zhvillimin e fëmijës.

- Kontakte telefonike ose përmes adresave elektronike me prindin/in, në rast se ka diç më specifike për të cilën duhet të dijë prindi.
- Takime informuese me specialistët e fushës së arsimit parashkollor, në të cilat hsqyrtohen temat që u interesojnë prindërve.
- Bisedai konkrete me prindin, për çdo nevojë urgjente.

Edukatorja si eksperti i punës, bartë përgjegjësinë për funksionimin e duhur të këtij bashkëpunimi. Ajo është kompetentja që bartë informacionet e identifikuara rreth fëmijës, te prindi dhe ajo e cila kërkon informata nga ai.

Nga qasja serioze dhe e qëlluar ndaj çështjes së bashkëpunimit me prindër, varet edhe sukcesi i përgjithshëm i punës së institucionit parashkollor, dhe i edukatores në veçanti. Bashkëpunimi edukatore - prind, mund të jetë i suksesshëm, vetëm kur të dy palët, vazhdimisht përcjellin dhe kontribuojnë në rritën dhe zhvillimin e gjithanshëm, të fëmijës. Edukatorja, gjatë punës së saj të përditshme, gjatë realizimit të aktiviteteve me fëmijët, duhet të bëjë vëzhgimin e përgjithshëm të tyre dhe në bazë të këtij, ajo din dhe mund të konstatojë përparimin e zhvillimit të fëmijëve në të gjitha aspektet; shkallën e angazhimit fizik të fëmijës, gjendjen emocionale e shpirtërore të tij, nivelin e ndërveprimit dhe socializimit, gatishmërinë për komunikim, si dhe aftësitë e tij specifike apo edhe ngecjet eventuale. Për të gjitha këto lloj zhvillimesh, edukatorja duhet ta informojë prindin, në mënyrë që ai të merret vazhdimisht, me afinitetet e avancuara të

fëmijës (që t'i perfeksionojë e kultivojë më shumë ato) dhe në mënyrë të veçantë, me pikat më pak të avancuara të fëmijës, që së bashku me edukatoren të ndikojë në forcimin e tyre. Pa ndihmën e prindit, edukatorja e ka të pamundur të merret aq sa duhet dhe sa ka nevojë, me secilin fëmijë, në mënyrë të veçantë (për shkak të numrit të madh të fëmijëve, që posedon në grup). Po ashtu edhe prindi, pa komunikuar me edukatoren, e pa qen i informuar për reflektimin e fëmijës së tij në lojë e në aktivitete të kopshtit, nuk mund ta trajtojë në mënyrë të duhur, fëmijën e tij në shtëpi. Sepse, dihet që secili fëmijë, është unikat në vete. Duke u nisur nga ky fakt, ndër parimet e edukimit parashkollor, është edhe parimi i respektimit të unikalitetit-individualitetit tek fëmija. Për këtë arsye, prindi duhet të dijë çka të kërkojë nga edukatorja dhe çka t'i ofrojë asaj. Po ashtu edhe edukatorja, duhet të dijë çka të kërkojë nga prindi dhe çfarë informacione t'i japë atij rreth fëmijës, i cili është një objektivë e përbashkët e tyre. Si rezultat i një bashkëpunimi profesional nga ana e edukatores, dhe i një bashkëpunimi serioz e të përkushtuar nga ana e prindit, fëmija është i shëndetshëm, i zhvilluar gjithanshëm, i trajtuar mirë e drejt, si në kopsht ashtu edhe në shtëpi. Kështu, puna në institucione parashkollore ,do të jetë më cilësore dhe më e suksesshme. Familja-prindërit, do ta kenë më të lehtë , ta rrisin fëmijën dhe do të jenë më të lumtur, me zhvillimin e tij. Ky rezultat, arrihet tek të gjithë fëmijët (tek të gjithë në mënyrë relative), atëherë kur edukatorja, prindin e sheh, e trajton, si informatorin dhe partnerin më të mirë e më të besueshëm, për punën me fëmijën, si dhe atëherë kur institucioni parashkollor, ka qasje profesionale ndaj prindit dhe në kontinuitet komunikon me të, konsultohet për gjithçka rreth fëmijës, e përfshinë në

përpilimin e planeve të punës, në organizimin e projekteve, në realizimin e shumë temave dhe aktiviteteve të punës.

Meqenëse bashkëpunimi me prindër, nuk është aspak i thjeshtë dhe duhet të jetë shumë përmbytësor dhe i efektshëm, si kriter kyç i një bashkëpunimi të tillë, duhet të jetë përshtatshmëria me kulturën familjare. Edukatorja duhet ta njohë dhe ta respektojë mentalitetin dhe nivelin intelektual të prindit-familjes, së fëmijës. Kjo edhe i përcakton ose kushtëzon, alternativat e komunikimit dhe të bashkëpunimit me të. Pastaj, bashkëpunimi kushtëzohet, edhe nga struktura familjare e fëmijës (a i ka ai të dy prindërit dhe me cilët anëtarë të familjes jeton). Varësisht nga kjo, edukatorja edhe has në interesimin e familjes për bashkëpunim dhe merr informata për fëmijën. Sepse anëtarët tjerë të familjes së fëmijës (që i mungon njëri ose të dy prindërit) dhe prindërit me nivel më të mangët kulturor dhe emancipues, janë më të ngurtë dhe jo shumë të afërt, në komunikim . Pastaj, disa nga prindërit, me vështirësi e pranojnë problemin, ngecjen apo të metat e fëmijës. Ky nivel i prindërve kanë një lloj frike, të ndërhyjnë në punët e institucionit dhe në trajtimin e fëmijës së tij. Kështu që, nevojitet që edukatorja, të jetë e përgatitur në mënyrë profesionale, (përfshirë edhe aspektin psikologjik të qasjes) që bashkëpunimin me prindër, t'ia përshtatë nivelit të edukimit dhe specifikave familjare. Një komunikim i tillë (edukator-prind), ia lehtëson shumë punën me fëmijët vet edukatores, dhe prindërve u mundëson një trajtim të nevojshëm e adekuat ndaj fëmijës së tyre. Si e tillë (edukatorja e përgatitur profesionalisht), inkurajon të gjithë prindërit, për bashkëpunim e informim reciprok rreth fëmijës dhe ky reciprocitet, patjetër që do të sigurojë „përfitime” për fëmijën, prindin dhe vet institucionit parashkollor. Pra, „Angazhimi i prindërve, është një element shumë domethënës, për

institucionin parashkollor. Mirëpritja, duhet të fillojë, që në ditëntakimin e parë të tyre, me edukatoren-institucionin. Prindërit, duhet të konsiderohen si specialistë, për fëmijët e tyre dhe si pjesëmarrës aktiv, në procesin e zhvillimit dhe të edukimit të këtyre fëmijëve. Prandaj është e preferuar që, të gjitha institucionet parashkollore, ta vlerësojnë dhe ta institucionalizojnë, partneritetin „edukator-prind”. (Vadahi 2002, f. 94).

1.2 Prindi si faktor i edukimit të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme dhe si bashkëpunëtor i edukatores

Prindi është faktori më përgjegjës për zhvillimin e duhur të fëmijës, për krijimin e një atmosfere të shëndoshë dhe edukative në shtëpi, për organizimin komod të jetës, si dhe për përzgjedhjen me kujdes të metodave të edukimit në familje, në përshtatje me rrethanat familjare dhe veçoritë e fëmijës së vet. Duke u bazuar në nevojat permanente, për një trajtim adekuat të prindit ndaj fëmijës së tij, ai vetëm përmes ndihmës dhe bashkëpunimit me edukatorin, mund të realizojë, përpjekjen e tij, për një qasje sa më të gjithanshme dhe më efektive për zhvillimin holistic të fëmijës. Kujdesi dhe edukimi i prindërve, përveç që duhet të orientohet kah aspekti i zhvillimit fizik-motorik, njohës, emocional, etj, ai duhet të bëjë përpjekje edhe për kultivimin (te fëmija) e disa vetive që janë vendimtare në formimin e personalitetit dhe përgatitjen-kalitjen e tij, për jetën e mëtutjeshme. Lidhur me këtë, janë edhe disa strategji universale të komunikimit me fëmijët, të cilat ndikojnë në krijimin e disa vetive po ashtu universale, që vlejnë për prindërit dhe fëmijët e të gjitha familjeve, shoqërive dhe kulturave.

Ato janë:

-T'u mundësojnë fëmijëve një fëmijëri të lumtur, që ata të ndihen të kënaqur dhe të mbështetur në çfarëdo aspekti, kurdo që ata janë në vështirësi .

-T'u ofrojnë fëmijëve, sa më shumë dashuri që të rriten me ndjesinë se, të japësh dhe të marrësh dashuri të bën të ndjehesh mirë me veten.

-T'u ofrojnë fëmijëve siguri, jo vetëm fizike por edhe t'u krijojnë një jetë pa ndryshime te shpeshta dhe drastike që i bën të ndjehen të pasigurt.

-T'u ofrojnë fëmijëve mundësi për krijimin e ndjenjës së pavarësisë, ngase ata kanë shumë energji dhe dëshirë për të njohur, eksploruar botën dhe për të vepruar me kokën e vet. Ky atribut i tyre, duhet të nxitet e të kultivohet nga ana e prindit, si një dëshirë shumë pozitive.

- T'u ofrojnë fëmijëve mundësi motivuese, që të ndihen krenar me veten, t'u nxisin talentin, duke ua potencuar sjelljet e mira, sukseset në lojëra, duke i lavdëruar dhe duke i bërë që të ndihen mirë me atë çfarë janë. Sepse, fëmijët kanë nevojë t'u theksohen pikat e tyre të forta; veprimet, mënyrën si mendon, mënyra si luan, si buzëqesh, si këmbëngul, mënyra si i përballojnë zhgënjimet, si reziston, etj.

- T'u zhvillojmë shpresën, se kërkesat e tij, mund të realizohen, nëse mësohet të presë dhe të zhvillojë ndjeshmërinë e duhur, për kuptimin e situatës eventuale. Është e gabueshme, t'u thuhet fëmijëve, një jo e pa argumentuar. Gjatë argumentimeve, fëmija kupton dhe pajtohet me mos plotësimin e kërkesave të tij të paarsyeshme.

Këto attribute të personalitetit, prindi nuk mund t'i avancojë tek fëmija, vetëm gjatë kohës sa ai është në shtëpi, sepse pjesën kryesore të ditës, ai qëndron në institucion parashkollor. Prindi këto mund t'i realizojë, vetëm përmes një bashkëpunimi të qëllimshëm me edukatoren, e cila gjithsesi, që duhet të ketë qasje profesionale si ndaj fëmijës, ashtu edhe ndaj partneritetit me prindërit. Prindi po ashtu, duhet të jetë i ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka edukatorja, për zhvillimin e fëmijës së tij. Kjo rezulton nga fakti se fëmija, pjesën esenciale të ditës (zakonisht prej orës 8-16) e kalon në institucionin parashkollor dhe ai fëmijën e ka në dispozicion vetëm 3-4 orë para gjumit të tij, në fakt kohën kur ai edhe nuk është në gjendje optimale, që të aktivizohet apo edhe të absorbojë njohuri dhe përvoja nga „situatat”, të cilat mund t'i ofrohen në shtëpi, gjatë asaj kohe.

Prindi është burimi i vetëm dhe më i rëndësishëm i informacioneve lidhur me fëmijën, gjegjësisht rritjen e zhvillimin e tij të përgjithshëm. Prandaj, ai duhet të krijojë raport bashkëpunues me edukatoren, t'i besojë asaj dhe të transmetojë tek ajo, në mënyrë të sigurtë, informacione e të dhëna, lidhur me fëmijën. Kurse edukatorja, duhet ta respektojë e ta dëgjojë me vëmendje prindin. T'i marrë parasysh të gjitha ato që i thotë ai për fëmijën e vet, sepse këto e ndihmojnë shumë atë (edukatoren), në njohjen e fëmijës dhe në trajtimin, sipas nevojave që ai ka. Pra, bashkëpunimi reciprok, është domosdoshmëri për edukatoren dhe shumë stimulues për prindin, i cili e ka fëmijë në kopsht. Prania e prindit në institucionin parashkollor, është nevojë permanente dhe obligim etik, social, ligjor e institucional. Mirëpo, prindi ka nevojë për përkrahjen e edukatores dhe nga përkrahja dhe qasja e saj, varet edhe prania e tij në institucion. Kështu që, për të qenë prindi bashkëpunues dhe aktiv, më funksional e më efektiv, duhet

të inkurajohet nga edukatorja ose nga institucioni parashkollor. Afërsia dhe komunikimi mes prindit dhe edukatores, e ndihmon shumë punën e edukatores dhe e shton efikasitetin e shërbimit të përgjithshëm të IP-së, ndaj fëmijës. Njëkohësisht, ky bashkëpunim, është edhe emancipues për prindin dhe shton përkujdesin e duhur, të prindit ndaj fëmijës së tij. Kështu, ai përmes lojës dhe përkushtimit që bën ndaj fëmijës në shtëpi, e plotëson edukatoren, në ato çka ajo nuk ka mundë t'i arrijë në kopsht me të. Ky lloj reciprociteti, patjetër që reflekton, përveç në zhvillim të fëmijës, edhe në disponimin, vetëbesimin, sigurinë dhe mirëqenien e tij fizike, psikike e shpirtërore.

Ndërkaq familja, prindi duhet ta njohë dhe ta respektojë profesionin, njohuritë dhe eksperiencën e edukatores. Duke kontribuar në një respekt dhe sinqeritet reciprok, prindi nuk duhet të ngurojë, të komunikojë me edukatoren në forma e alternativa, që janë të mundshme dhe të përshtatshme siç janë; takime sipas nevojave, shkresa, biseda përmes telefonit, informim përmes fotove, etj.

Prindi duhet të jetë ndihmës i edukatores, për zhvillimin e fëmijës në çdo aspekt. Ai duhet të kontribuojë edhe në realizimin e qëllimit të programeve, të aktiviteteve më fëmijët dhe në përpilimin e strategjive për trajtim afatgjatë të fëmijës dhe eventualisht, të ndonjë situatë sfiduese (në raste të caktuara të përpilimit të ndonjë plani individual për ndonjë fëmijë me specifika në zhvillim, etj). Dihet që edukatorja, është ekspert në aspekt pedagogjik, kurse prindërit kanë njohuri nga përvoja jetësore, për fëmijët që i rrisin dhe mirëfilli dinë gjithçka për fëmijët e tyre. Kështu që ata mund të punojnë së bashku, për të mbështetur fëmijën në përfitime të zhvillimit të shumanshëm, në vlerësim të fëmijës, po ashtu edhe në shtimin e të nxëniet në shtëpi

edhe pas orarit të qëndrimit të fëmijës, në institucionin parashkollor. Në raste të veçanta, prindi nuk duhet të hezitojë edhe për ndonjë ftesë edukatores, për vizitë në shtëpi, me ç'rast, fëmija do të përfitonte shumë, në aspekt të miqësisë me edukatoren dhe në shtim të konfidencës në kopsht.

Duke u bazuar në komunikimin dhe bashkëpunimin tonë (si autore e hulumtimit), me institucionet parashkollore dhe me edukatorët në mënyrë të posaçme, kemi vërtetuar se prindërit kanë një qëndrim dhe komunikim më shumë formal e pasiv, se sa aktiv e sugjerues ndaj edukatores. Kjo mund të ndodhë për shumë arsye: për shkak të nivelit arsimor të prindërve, për shkak të neglizhimit të rëndësishëm që ka edukimi parashkollor (mendimit se aty ka vetëm përkujdesje e më pak zhvillim edukativ), për shkak të vështirësive në punën e jetën e përditshme. Mbi të gjitha, për shkak se në shoqërinë tonë, prindërit nuk janë të parapërgatitur (nga institucionet kompetente), për t'u bërë prindër bashkëpunues dhe për ta realizuar një bashkëpunim cilësor me institucionin dhe me edukatoren si një kujdestare, që tërë ditën, i ka nën përkujdesje fëmijët e tyre.

Marrëdhëniet prind-edukatore, konsiderohen si të suksesshme, kur ata së bashku bëjnë plane të punës, bëjnë realizim të aktiviteteve me fëmijët, kur përcjellin zhvillimin e fëmijës, kur ata këmbëjnë informata rreth fëmijës. Duke u angazhuar së bashku për fëmijën, arrijnë rezultate konkrete; tejkalojnë situata, ngecje ose vështirësi eventuale të natyrave të ndryshme si dhe sigurojnë zhvillim cilësor, të gjithanshëm e të shëndetshëm të fëmijës.

1.3 Qasja profesionale e institucionit parashkollor, ndaj bashkëpunimit me prindër

Studimet e shumta shkencore nga fusha pedagogjike, psikologjike, sociologjike e antropologjike, rekomandojnë që fëmija duhet të rritet në një mjedis të shëndoshë familjar, i cili ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe kahjet zhvillimore të fëmijës.

Familja është bartëse e ndikimeve të rëndësishme, në zhvillimin e fëmijës, prandaj, nuk ka edhe si të anashkalohet, ndikimi i familjes në edukimin e fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme. Për këtë arsye, një nga parimet kryesore të çdo programi dhe dokumentacioni ligjor, lidhur me edukimin parashkollor, trajton çështjen e angazhimit të familjes (prindërve) në institucionin parashkollor.

Edukimi parashkollor, në filozofinë e vet, përmban një kombinim e harmonizim spontan të; „edukimit, lojës së fëmijëve dhe përkujdesjes profesionale” (PSAK,2011. f.56). Për t’i realizuar të gjitha këto komponentë të punës me fëmijët, në një fazë të hershme të edukimit, siç është edukimi në fëmijërinë e hershme, është një problem shumë delikat dhe të cilin si institucionet për parashkollor, po ashtu edhe familjet, gjegjësisht prindërit, nuk mund ta realizojnë të vetëm. Mundësia e kësaj është, vetëm përmes një bashkëpunimi permanent, të këtyre dy institucioneve: Institucionit Familje dhe Institucionit Parashkollor.

Për këto arsye, ky bashkëpunim është i domosdoshëm dhe i pa kompenzueshëm. Është i rëndësishë së tillë, vetëm nëse është i mirëfilltë dhe efikas. Bashkëpunimi edukator-prind, konsiderohet cilësor e profesional, kur të dy palët janë të interesuara për këtë,

kur të dy palët tregojnë përkushtim e kujdes të vëmendshëm për fëmijën dhe kur të dy palët, informohen reciprokisht për gjithçka rreth tij. Kujdesi dhe njëkohësisht komunikimi i tyre lidhur me fëmijën, duhet të orientohet në shumë aspekte: në aspektin e shëndetit fizik, psikik, intelektual, emocional, përkatësisht për përparësitë e ngecjet e përgjithshme të fëmijës nga të gjitha aspektet e zhvillimit.

Për krijimin e një klime të mirë bashkëpunuese dhe për qasjen pozitive e profesionale ndaj prindit si bashkëpunëtor, doemos që përgjegjësia i takon së pari edukatores, si pjesë të punës së saj që e ka, sepse, prindërit sado të ngritur dhe të emancipuar të jenë, shumë prej tyre, ngurojnë të ofrohen dhe të komunikojnë lirshëm me edukatoren, në mënyrë të afërt, për gjithçka rreth fëmijës së tyre. Edukatorja është ajo, së cilës i takon ta zbatojë njërin ndër parimet kryesore të punës në Edukimin Parashkollor e që është, komunikimi dhe bashkëveprimi me prindër. Në bazë të kësaj, ajo duhet t'i kushtojë shumë rëndësi planifikimit dhe realizimit të kësaj pike të veçantë dhe të domosdoshme, për punën e saj. Prindi është burimi më i mirë, i njohurive për secilin fëmijë dhe partneri më i rëndësishëm, për punën e edukatores, sepse;

-Vetëm prindi, ka qëllime ideale, vullnet të madh dhe dëshira për fëmijën e vet.

-Prindi di më së miri, çfarë di, çfarë do dhe çfarë mund të bëjë fëmija i tij.

-Prindi njeh më së shumti preokupimet, temperamentin dhe personalitetin e fëmijës së vet.

Prandaj, ndër kriteret e një bashkëpunimi profesional dhe që ndikon drejtpërdrejtë në trajtimin e duhur dhe në zhvillimin e

fëmijës, është komunikimi i sinqertë, reciprokisht, në mes të edukatores dhe prindit. Nëse edukatorja krijon raporte të sinqerta dhe është e përkushtuar ndaj fëmijës, ajo identifikon vëmendshëm dhe informon prindin për të arriturat dhe aspektet më delikate të fëmijës. Po ashtu, nëse prindi sinqerisht e informon edukatoren për gjithçka rreth fëmijës së vet, ata të dy do të koordinojnë angazhimin dhe kujdesin rreth fëmijës, e në këtë mënyrë, do të plotësojnë njëri-tjetrin në zhvillimin adekuat e të nevojshëm të tij. Pa një bashkëpunim të tillë të mirëfilltë, fëmija nuk trajtohet në mënyrë të qëlluar dhe efikase nga asnjëra palë, (as nga prindi as nga edukatorja). „Prindi mund të jetë një partner shumë i dobishëm i punës së edukatores dhe një ndihmës me vlerë, në procesin e qasjes individuale të fëmijës, por ai jep edhe kontribut të përgjithshëm, për të gjithë grupin e fëmijëve dhe institucionin parashkollor”. (Miller,2007, f. 227). Prindi dhe familja në tërësi, janë një urë lidhëse, në mes të të nxënit e fëmijës në kopsht, dhe të nxënit në shtëpi. Ndërsa, „E drejta për iniciativa, organizim dhe planifikim të bashkëpunimit edukator-prind, i takon kryesisht, institucionit”. (Deva-Zuna& bashkëpunëtorët, 2009, f. 43)

II-METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

2.1. Rëndësia e hulumtimit

Edukimi është një proces i cili fillon, me fillimin e jetës së fëmijës, d.m.th. qysh prej lindjes së tij, po ashtu edhe studimet pedagogjike e psikologjike e vërtetojnë se, 6 vjetët e para të jetës, ose vitet e fëmijërisë së hershme, kanë ndikim vendimtar në zhvillimin dhe në formësimin e personalitetit të njeriut. Kjo moshë është e rëndësishme, për trajtimin e duhur dhe profesional të fëmijës, sepse zhvillimi i fëmijës në vitet 0-6 vjet, konsiston në zhvillimin e aspektit shëndetësor fizik, emocional, mendor, social dhe njohës. Mu për këtë arsye, nuk duhet lejuar që të anashkalohej procesi edukativ, për grupmoshat e fëmijërisë së hershme. „Zhvillimi i personalitetit gjatë fëmijërisë së hershme, kryhet në mënyrë shumë progresive, konsekuente dhe koherente, përmes të cilës arrihet tek pjekuria.” (Deva Zuna, 2003,f.53.)

Prandaj, edukimi i nivelit parashkollor, ka specifikat e veta dhe si qëllim ka, respektimin e karakteristikave të veçanta dhe të përgjithshme të fëmijëve, të moshës parashkollore, duke përfshirë edhe individualitetin specifik, potencialin gjenetik dhe cilësinë e zhvillimit të tyre. Duke qenë kështu, edukimi parashkollor është vënë në fokus të sistemit arsimor të secilit shtet dhe shoqëri përparimtare. Me qëllim të zhvillimit sa më cilësor të fëmijëve të kësaj moshe, edhe tek ne janë duke u bërë përpjekje, për ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe të prindërve, për rëndësinë që ka ky nivel i edukimit.

Ndër faktorët përcaktues të cilësisë së edukimit parashkollor dhe që ndikon drejtpërdrejt në efikasitetin e zhvillimit të gjithanshëm të fëmijës, është bashkëpunimi i institucioneve parashkollore dhe edukatores me prindër. Prindërit janë faktorët qenësor që

ndikojnë në zhvillimin dhe edukimin e fëmijëve. Edukimi i fëmijës është një proces i vështirë dhe një interesim i vazhdueshëm i prindit, i cili realizohet gjatë komunikimit të përditshëm e spontan me fëmijët, në shtëpi apo ambientin ku ata jetojnë. Prandaj, bashkëpunimi edukator-prind, është kusht i domosdoshëm, për realizimin e mirëfilltë të punës me fëmijët në Edukimin parashkollor. Qasja profesionale e edukatores ndaj bashkëpunimit me prindër, është nevojë e pa kompenzueshme dhe jashtëzakonisht e dobishme, për zhvillimin e plotë, të drejtë e të gjithanshëm të fëmijës. Për këtë arsye, njëra ndër parimet kyçe të edukimit parashkollor, pothuajse në të gjitha vendet e botës e edhe në Kosovë, është zbatimi funksional, i raportit edukator-prind. Ky parim, zë vend të veçantë në „Kurrikulën për edukimin parashkollor”, në Ligjin për Parashkollor, të vitit 2006, në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, dhe pothuajse në të gjitha dokumentet, që kanë të bëjnë me këtë nivel të edukimit. Meqenëse raporti i mirëfilltë edukator-prind është kusht, që një institucion parashkollor dhe zhvillimi i fëmijës të jetë i suksesshëm, Institucioni Pedagogjik i Kosovës, e ka parë të nevojshme, ta realizojë studimin „Raporti edukator-prind në institucionet publike dhe private të Kosovës”, me synim që të dalë me të dhëna dhe sugjerime konkrete të prindërve dhe edukatorëve si dhe me sugjerimet e rekomandimet për kompetentët dhe të gjitha palët e interesit.

2.2. Objekti i hulumtimit

Si objekt hulumtimi është, bashkëpunimi edukatore-prind, gjegjësisht zbatimi në praktikë i këtij bashkëpunimi, në institucionet parashkollore të Kosovës.

2.3. Qëllimi dhe detyrat e hulumtimit:

Të mblidhen të dhënat konkrete nga terreni, për të konstatuar se si funksionon bashkëpunimi edukator-prind, në institucionet parashkollore publike dhe private të vendit dhe për të parë se sa është ky bashkëpunim profesional, sa efektiv dhe sa vetëm formal. Për të arritur qëllimin e këtij hulumtimi, kemi realizuar këto detyra ;

- Studim kabinetik (literaturë profesionale) lidhur me këtë çështje.
- Përgatitja e instrumenteve hulumtuese (për prind-edukator)
- Realizimi në terren i instrumentit
- Grumbullimi i të dhënave
- Përpunimi dhe analiza e të dhënave
- Paraqitje në mënyrë grafike e të dhënave
- Interpretimi-komentimi i rezultateve
- Konkluzionet dhe rekomandimet
- Përgatitja e raportit dhe publikimi i tij

2.4. Pyetjet e hulumtimit

- Si realizohet bashkëpunimi prind-edukatore?
- Sa është efektiv ky bashkëpunim në zhvillimin e fëmijës?
- Kush është përgjegjës në këtë bashkëpunimin?
- Cili është roli i edukatores në raport me fëmijën dhe prindin?

- Cili është roli i prindit në raport me edukatoren dhe fëmijën?
- Cila është pjesëmarrja e prindërve në institucionet parashkollore?
 - Gjatë realizimit të kurrikulës dhe standardeve për fëmijët parashkollor
 - Gjatë përpilimit të planeve (tematike, javore, mujore dhe vjetore)
 - Gjatë planifikimit të aktiviteteve
 - Gjatë realizimit të punës edukativo-arsimore
 - Gjatë realizimit të projekteve të veçanta?

2.5. Hipoteza e hulumtimit

Bashkëpunimi edukatore-prind, i zbatuar në institucionet parashkollore, nuk është i nivelit dhe cilësisë së dëshiruar.

Hipoteza ndihmëse: Bashkëpunimi i planifikuar mirë dhe i bazuar në strategji-alternativa të përshtatshme, reflekton dukshëm në cilësinë e punës së edukatores dhe të zhvillimit të fëmijës.

2.6. Popullacioni dhe përzgjedhja e mostrës

Mostra në këtë hulumtim, përbën 30% të popullacionit. Pra nga gjithsej 46 institucione parashkollore publike, si mostër për hulumtim kemi marrë 6, kurse numri i institucioneve parashkollore private, të përfshira në hulumtim, është 9.

Për përzgjedhjen e mostrës nga institucionet parashkollore, kemi shfrytëzuar të dhënat që i kemi nga Ministria e Arsimit Shkencës

dhe e Teknologjisë, ku figurojnë të gjitha institucionet parashkollore publike dhe një pjesë e institucioneve parashkollore private (vetëm një pjesë, sepse një numër i konsiderueshëm i tyre, janë të palicencuara).

2.7. Instrumentet e përdorura:

Hulumtimi është realizuar përmes pyetësorit për edukator dhe prindër.

2.8. Dinamika e hulumtimit:

Hulumtimi është zhvilluar përmes pyetësorëve dhe në fokus të studimit kishin, institucionet publike, institucionet private dhe një mostër të komunitetit të prindërve.

Si institucionet parashkollore, ashtu edhe prindërit, janë zgjedhur në mënyrë spontane, duke u bazuar në të dhënat statistikore të numrit të institucioneve që ka MASHT-i, gjegjësisht duke u bazuar në listat e prindërve të fëmijëve, që posedojnë edukatorët.

Të gjitha edukatoreve të IP-ve dhe prindërve, ua kemi shpërndarë pyetësorët në ditë pune, të cilët i kanë plotësuar në mënyrë subjektive, të pavarur në prani tonën dhe duke u lënë kohë të mjaftueshme për plotësimin e tyre, në kohën kur ato e kishin më të lirë.

Vlen të theksohet që pyetësorët, respondentëve, u janë dhënë në zarfe të mbyllura, duke siguruar anonimitetin e konfidencialitetin e performancës rreth këtij problem, si të prindërve, ashtu edhe të edukatoreve.

Për përpunimin e të dhënave nga pyetësi, përmes paraqitjes tabelore, është aplikuar metoda EXCEL. Për plotësim të paraqitjes së problematikës, është zbatuar edhe metoda deskriptive-përshkrimi dhe trajtimi më i detajuar i çështjes së komunikimit edukator-prind.


III. REZULTATET E HULUMTIMIT-ANALIZA DHE INTERPRETIMI

Të dhënat e mëposhtme, pasqyrojnë perceptimet e edukatoreve të 6 institucioneve parashkollore publike dhe të edukatoreve të 9 institucioneve parashkollore private. Kemi paraparë që mostra më e madhe se 10 % e popullacionit, do të jetë e mjaftueshme për të reflektuar realitetin e kësaj çështjeje (raportit edukator-prind) si dhe do ta ketë besueshmërinë e qëndrueshme.

Në bazë të të dhënave nga terreni, shohim se çështja e raportit edukator-prind, nëpër komuna dhe institucione parashkollore të ndryshme, është pothuajse e njëjtë, ose dallon shumë pak.


3.1. Të dhënat nga edukatorët

Në grafikun nr.1, shihet numri i institucioneve ku është realizuar hulumtimi.



Grafiku nr. 1 –Numri i institucioneve të përfshira në hulumtimin


Ky grafik, siç po shihet, paraqet moshën e edukatoreve të përfshira në hulumtim dhe në bazë të këtyre shifrave, shihet që, nga 64 edukatore shumica, ose 82% janë nën moshën 50 vjeçare, që d.m.th. janë të moshës relativisht të re dhe të kualifikuara sipas programeve të fundit.



Grafiku 2. Moshë e edukatoreve


Grafiku nr.3, reflekton lidhur me kualifikimin e edukatoreve. Sipas saj shihet që 11% e edukatoreve të përfshira në hulumtim, janë me shkollë të mesme, (këto zakonisht, punojnë me fëmijët e moshës më të vogël, 0-2 vjeç, të cilët kanë nevojë më shumë për përkujdesje dhe ndihmë sesa për edukim. Gjatë zhvillimit, fëmijëve u shtohet niveli i edukimit dhe ofrimit të njohurive dhe bie niveli i përkujdesjes ndaj tyre, sepse ata, për çdo ditë, shkojnë duke u pavarësuar). Pastaj 22% e edukatoreve janë me Shkollë të Larta Pedagogjike, (këto janë në proces të vijimit të kualifikimit, për ta bërë 4 vjeçar), 64% e edukatoreve, janë me kualifikim të

lartë-fakultet, ndërkaq 3% nga ato janë me master të përfunduar në drejtime të ndryshme të Fakultetit të Edukimit.




Grafiku 4: Kualifikimi i 64 edukatoreve respondente

Kjo tabelë pasqyron përqindjet se sa janë trajnuar edukoret, në programet e ndryshme të trajnimeve.



Grafiku 4: Trajnimet e ndjekura nga edukatorët


Sipas grafikut të mëposhtëm, 77% e edukatoreve, konsiderojnë që, bashkëpunimin me prindër, e kanë të kënaqshëm. Kurse është për t'u analizuar çështja se cilin bashkëpunim e konsiderojnë edukatorët si të kënaqshëm e të suksesshëm. Në fakt, një pjesë e edukatoreve, nuk kanë informacione të duhura për këtë bashkëpunim, për rëndësinë e tij dhe nuk kanë shumë ide as alternativa, për ta realizuar këtë në mënyrë të duhur. Prandaj, në institucionet tona parashkolllore, zakonisht bashkëpunimin e bëjnë formal dhe jo shumë funksional, në aspekt të plotësimeve zhvillimore të fëmijës gjë që është një mangësi e madhe me të cilën duhet të merremi, më me kompetencë dhe më me seriozitet.



Grafiku 5. Bashkëpunimi me prindër


Sipas të dhënave në këtë grafik, gati gjysma e prindërve (48%), çdo ditë interesohen dhe bëjnë pyetje të përgjithshme për fëmijën.

Pyetja nr. 7 se si informoheni rreth fëmijëve që keni në grup, kishte këto alternative të përgjigjeve:




Grafiku 6. Përgjigjja 6.1: Prindit i bëj pyetje të përgjithshme për fëmijën

Pra sipas përgjigjeve të dhëna nga edukatorët, 94% e tyre janë të kujdesshme dhe vazhdimisht, prindërve u bëjnë pyetje edhe specifike për zhvillimin individual të fëmijëve që i kanë nën përkujdesje.




Grafiku 7. Prindit i bëj pyetje specifike lidhur me zhvillimin individual të fëmijës

Sipas të dhënave (ku objektiviteti i respondentëve është shumë relativ) shumica e edukatoreve (73% e tyre), në mënyrë permanente, i vëzhgojnë dhe i vlerësojnë në mënyra të ndryshme, angazhimin e fëmijëve në aktivitetet ditore e pastaj, në kontinuitet, i informojnë prindërit për rezultatet e tyre. Kështu që, ato (edukatorët), fëmijët, më së shumti i njohin përmes vëzhgimit që u bëjnë atyre.




Grafiku 8. Vlerësimi-vëzhgimi i fëmijës për përfshirje në aktivitete dhe informimi i prindit lidhur me këto

Në këtë grafik, të lë përshtypje e dhëna, sipas të cilës, vetëm 10% e edukatoreve konsultohen çdo herë me prindërit gjatë planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve. Kjo nënkupton që, nuk bashkëpunojnë as nuk konsultohen me prindërit gjatë planifikimit të punës së tyre as nuk i përfshijnë ata në realizim të aktiviteteve.




Grafiku 9: Përgjigjja 8.1 Bashkëpunim me prindërit në përpilimin e planit të punës

Kjo shifër tregon, që shumë pak ose vetëm 3% e prindërve janë, çdoherë, të gatshëm, të ndihmojnë punën e edukatoreve në institucionin parashkollor. Shpresojmë që kjo nuk ka të bëjë me mungesën e gatishmërisë për shkak të mungesës së vullnetit që ata të kontribuojnë në punën dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Por hipotetikisht e themi që, ata e kanë të pamundur të jenë çdoherë të gatshëm, për shkak të punës dhe angazhimeve në jetën e tyre.




Grafiku 10. Ndihma dhe pjesëmarrja e prindërve në realizimin e aktiviteteve

Nga përgjigjet e kësaj pyetjeje shihet që pjesa më e madhe e edukatoreve, jo çdo herë, bashkëpunojnë me prindërit në mënyra alternative dhe sipas nevojave që ka fëmija, apo edhe sipas mundësive që ka prindi. Pra, këtë mund ta bëjnë shpesh, por jo çdo herë. Njëra ndër arsytet që kushtëzojnë rezultatet e kësaj tablele është edhe numri i madh i fëmijëve, që posedon një grup dhe edukatorja e ka të pamundur, të arrijë t'i përkushtohet secilit fëmijë, aq sa duhet dhe aq sa ai ka nevojë.




Grafiku 11. Bashkëpunimi me prindër, në mënyra alternative, varësisht nga nevojat e fëmijëve.

Grafiku mëposhtëm, tregon që pothuajse gjithëherë (83% të rasteve), edukatorët dhe prindërit, gjatë pranimit-dorëzimit të fëmijës, kanë takime sporadike apo spontane, në të cilat informohen reciprokisht rreth fëmijës.




Grafiku 12. Takimet e përditshme informuese me prindërit gjatë pranimit-dorëzimit të fëmijëve.

Sipas grafikut pasues, edukatoret nuk e realizojnë shumë bashkëpunimin me prindërit sipas ndonjë protokollit të planifikuar e profesional. Vetëm 36% e edukatoreve, gjithnjë e bëjnë këtë në mënyrë të planifikuar dhe të protokolluar. Kjo d.m.th., që bashkëpunimit me prindër, shumë nga edukatoret, nuk i kushtojnë shumë rëndësi, nuk e trajtojnë me seriozitet, as nuk e planifikojnë, por e realizojnë, në mënyrë spontane dhe të pa aranzhuar mirë.




Grafiku 13. Takimet e përgjithshme me prindërit sipas protokollit dhe planifikimit

Përqindjet e paraqitura në grafikun e mëposhtëm, tregojnë që, jo shumë shpesh, përdoret si mjet informimi telefoni. Arsyet për këtë, sigurisht që janë të ndryshme (p.sh. kostoja, mundësia modeste e shprehjes, etj.)




Grafiku 14. Komunikimi dhe informimi i prindërve përmes telefonit

Ndërkaq ky grafik, dëshmon se edukatorët, për të informuar prindërit me planin e aktiviteteve, për shkallën e angazhimit dhe për çdo lloj zhvillimi të fëmijës, më së lehti e kanë që, atë ta bëjnë përmes tabelës së informatave, që është e vendosur në vendin e caktuar në institucionin parashkollor.




Grafiku 15: Vendosja e planit të aktiviteteve për grupin, në tabelën e informatave

Grafiku i radhës, vërteton që edukatorët, për komunikim dhe informim reciprok rreth fëmijës, shumë rrallë preferojnë që ta përdorin postelin (Posten elektronike = angl. Email), megjithëse kjo është një formë shumë praktike për bashkëpunim dhe që nuk kushton asgjë. Kështu është, për faktin se një numër shumë i madh i edukatoreve, (për çudi) nuk kanë fare të hapur adresë elektronike, e po ashtu një numër i konsiderueshëm e kanë por nuk e shfrytëzojnë aspak. Kjo nuk ndodhë vetëm tek edukatorët me më shumë përvojë jete dhe pune (ato që janë mbi 50 vjet), por edhe tek edukatorët relativisht të reja (nën 50vjet). Një pjesë e tyre kanë adresë, por nuk e shfrytëzojnë për bashkëpunim. Kjo nënkupton edhe një fakt tjetër të pakëndshëm; se edukatorët tona, e përdorin fare pak internetin, jo vetëm si mundësi e mirë për komunikim, por as si mundësi shumë të mirë për informim rreth fëmijës dhe botës së tij, rreth punës me ta dhe për avancim profesional.



Grafiku 16. Informimi i prindërve për gjithçka rreth fëmijës me postel.

Grafiku 17, paraqet rezultatin sipas së cilit, gati gjysma e edukatoreve respondente, pohojnë se me prindërit e fëmijëve takohen, vetëm sipas kërkesave të tyre. Kjo në fakt, „zbulon” problemin tjetër, që edukatoret tona pak vëzhgojnë-vlerësojnë zhvillimin dhe angazhimin e fëmijëve, kështu që nuk dine as nuk kanë, çfarë t’u thonë prindërve, për fëmijët e tyre (për ndonjë nevojë, ngecje apo arritje të veçantë të fëmijëve të tyre) kurse takimet i realizojnë vetëm me iniciimin e prindërve.



Grafiku 17. Takimi me prindërit varësisht nga nevojat dhe kërkesat e prindërve

Sipas grafikut 18, i cila reflekton për prindërit më bashkëpunues, shihet që gatishmërinë më të lartë për bashkëpunim, e kanë prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta (55%) dhe kjo është plotësisht e kuptueshme, sepse këtë e kanë të domosdoshme, për shkak të gjendjes specifike të fëmijë së tyre dhe punës me ta, sipas planeve individuale, dedikuar atyre. Pastaj të interesuar shumë janë edhe prindërit më të emancipuar e më të kualifikuar (23%),


kurse më së paku bashkëpunues janë (gjithnjë sipas të dhënave nga terreni), prindërit e fëmijëve më të avancuar në zhvillim.



Grafiku 18. Prindërit me të cilët keni bashkëpunim më efikas

Grafiku 29, tregon që 39% e edukatoreve të përfshira në hulumtim, takimet me prindër, i aranzhojnë, në marrëveshje me prindërit. Pothuajse caq (37%) prej tyre, takimet i përcaktojnë vet, kur atyre iu konvenon, kurse një pjesë relativisht e madhe, e edukatoreve (22%), thonë se takimet me prindër ua përcakton drejtoresha. Kjo qet në pah faktin se 22% e edukatoreve, në realitet, kanë takime me prindër, vetëm në raste të organizimit të ndonjë programi festiv në kopsht, apo në rast nevojë të mbajtjes së ndonjë takimi gjeneral në tërë institucionin parashkollor, e që nënkupton se, kjo pjesë e edukatoreve, nuk kanë fare bashkëpunim të veçantë e informues me prindërit për fëmijët. Në ato takime që i inicion drejtoresha, ato mund të thonë vetëm gjëra


dhe informacione shumë të përgjithshme rreth punës në institucionin parashkollor.



Grafiku 20. Inicimi i takimeve me prindër


Në këtë pyetje, 70% e edukatoreve që kanë plotësuar pyetësorin, kanë thënë që me prindërit kanë takim të përditshëm, përgjatë pranim-dorëzimit të fëmijes. Por, si duket, ato, me takim, kanë kuptuar një informim formal dhe bisedë rutinore rreth fëmijës.

Mund të thuhet kështu sepse, gjatë pranim-dorëzimit edukatorja nuk mund të ketë shumë kohë që të reflektojë për fëmijën as t'i përkushtohet asnjërit prej prindërve. Në atë kohë, ajo është e ngarkuar me përgatitjet për pranim ose dorëzim të fëmijëve, kur secili kërkon përkushtimin e vet. Kështu që, ky lloj takimi ose kjo alternativë e bashkëpunimit me prindër, është vetëm rutinore e nuk mund të ketë rezultate evidente.




Grafiku 21. Frekuenca e takimeve me prindërit dhe diskutimi rreth fëmijëve.

Se sa praktikohet si alternativë bashkëpunimi me prindër, mënyra tradicionale e institucioneve parashkollore, e emërtuar si „Dyert e hapura”, tregon grafiku i mëposhtëm, sipas të cilit, vetëm një e treta e edukatoreve, e shfrytëzojnë si metodë bashkëpunimi, një e treta thotë se e praktikon pak, kurse një e treta tjetër thotë nuk e aplikon fare këtë metodë, për të komunikuar me prindër.




Grafiku 22. Praktikimi i ditëve të dyerve të hapura

Meqenëse të gjitha edukatoret, në nivel të vendit (rreth 1300), kanë ndjekur trajnimin „Zbatimi në praktikë i Standardeve të Zhvillimit dhe Mësimi në Fëmijërinë e Hershme” i realizuar nga MASHT-i dhe IPK, edukatoreve u është bërë pyetja lidhur me ndikimin e këtij dokumenti, në bashkëpunimin me prindër dhe në planifikimin e punës së tyre. Dhe siç tregon tabela, qasja e re e edukatoreve ndaj prindërve dhe planifikimit të punës (duke u orientuar në dokumentin e Standardeve të Zhvillimit), ka ndihmuar në disa aspekte të zhvillimit të fëmijës. Pra, sipas grafikut të mëposhtëm, shihet që te 20% e edukatoreve, dokumenti gjithëherë, ndihmon në identifikimin e arritjeve e ngecjeve të fëmijëve, te 52% shumë shpesh e te 28% nganjëherë. Këto shifra tregojnë që, me zbatimin e këtij dokumenti në praktikën e punës së edukatoreve, bashkëpunimi edukator-prind, ka trend pozitiv.




Grafiku 23. Identifikimi i arritjeve dhe ngecjeve të fëmijës

Edhe ky grafik, pasqyron të dhënat që përmirësimi i raportit me prindër, te 45% e edukatoreve ka ndikuar në realizimin e aktiviteteve të planifikuara, te 30% ndikon shumë shpesh e te 25%, disa herë.



Grafiku 24. Ndikimi i zbatimit të dokumentit në realizimin e aktiviteteve të planifikuara


Në bazë të përgjigjeve të edukatoreve, përmirësimi i komunikimit me prindër (përmes zbatimit të dokumentit të SZhMFH), ka ndikuar shumë edhe në përmbushjen e nevojave individuale të fëmijëve. Më në detaje, për këtë, shihni në këtë grafik;



Grafiku 25. Ndikimi i zbatimit të dokumentit të SZhMFH në përmbushjen e nevojave individuale të fëmijës

3.2. Reflektimi i prindërve lidhur me bashkëpunimin edukator – prind

Nga këndvështrimi i prindërve, bashkëpunimi me institucionin parashkollor, gjegjësisht me edukatoren, është shumë në nivel. Që ky bashkëpunim është i tillë, deklarojnë shumica e prindërve respondentë apo 91% e tyre. Është një çështje tjetër, që duhet analizuar, se cilën alternativë të bashkëpunimit, prindërit e konsiderojnë si të nivelit të kënaqshëm. Prindi është burimi i vetëm dhe më i rëndësishëm i informacioneve lidhur me fëmijën, gjegjësisht rritjen e zhvillimin e tij të përgjithshëm. Prandaj, ata duhet të krijojnë raporte bashkëpunimi me edukatoren, t'i besojnë asaj dhe të transmetojnë tek ajo, në mënyrë të sinqertë, informacionet lidhur me fëmijën. Kurse edukatorja, duhet ta respektojë e ta dëgjojë me vëmendje prindin, dhe t'i marrë parasysh të gjitha ato që i thotë ai për fëmijën e vet, sepse e ndihmojnë shumë atë për njohjen e fëmijës dhe në trajtimin e tij sipas nevojave që ka. Pra, bashkëpunimi reciprok, është domosdoshmëri për edukatoren dhe shumë stimulues për prindin që ka fëmijë në kopsht.



Grafiku 1. Bashkëpunimi prind-edukatore (sipas prindërve)

Informimi i prindërve, rreth qëndrimit dhe zhvillimit të fëmijës, në institucionin parashkollor.

Të gjithë prindërit e intervistuar, përmes pyetësorit, kanë deklaruar se informatat për fëmijën i marrin nga edukatorja dhe nuk komunikojnë me askënd tjetër nga institucioni. Teksti i mëposhtëm tregon përgjigjet e prindërve, lidhur me informimin rreth qëndrimit dhe zhvillimit të fëmijëve, në IP.

- 19% e prindërve respondentë, kanë potencuar që për fëmijën e tyre, informohen çdo ditë nga edukatorët gjatë pranimit-dorëzimit
- 18% prej tyre, kanë thënë se me edukatorët, informohen reciprokisht për gjithçka rreth fëmijës, sipas nevojës.
- 18% e prindërve kanë deklaruar që bashkëpunimin me edukatoren e realizojnë në këto mënyra:
 - Çdo ditë e pyes edukatoren për zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës
 - Sipas nevojës, e pyes edukatoren për zhvillimin individual të fëmijës
 - Takohem me edukatoren, kur ajo kërkon që të na informojë për fëmijët
 - Reciprokisht informohemi për gjithçka rreth zhvillimit të fëmijës
- 10% e prindërve pohojnë se bashkëpunimin me IP e zhvillojnë në këto mënyrë:
 - Çdo ditë e pyes edukatoren për zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës

- Sipas nevojës e pyes edukatoren për zhvillimin individual të fëmijës
- Reciprokisht informohemi për gjithçka rreth zhvillimit të fëmijës
- 9% e prindërve bashkëpunojnë me edukatoren edhe në këto alternativa të bashkëpunimit;
 - Sipas nevojës e pyes edukatoren për zhvillimin individual të fëmijës
 - Takohem me edukatoren, kur ajo kërkon që të na informojë për fëmijët
 - Reciprokisht informohemi për gjithçka rreth zhvillimit të fëmijës

Realizimi i bashkëpunimit të prindërve me edukatoren

Format e bashkëpunimit të prindërve me edukatoren janë të ndryshme dhe këto varen, nga qasja e edukatores, nga gatishmëria dhe vullneti i prindit dhe nga rregullorja e institucionit parashkollor. Nga kjo del se nuk ka ndonjë standard të formave të bashkëpunimit në nivel të institucionit parashkollor, në nivel komune, apo në nivel vendi. Por, sipas prindërve që ne i kemi pasur për mostër të këtij hulumtimi, ata bashkëpunimin e realizojnë në këto forma;


- Në mënyra të ndryshme, sipas nevojës
- Me protokoll, sipas planifikimit
- Në ditën e dyerve të hapura
- Përmes komunikimit me telefon

- Përmes e-mailit
- Bashkëpunimi është në proces, në planifikim dhe realizim të aktiviteteve
 - **Në mënyra të ndryshme, sipas nevojës**, është forma përmes të të cilës, bashkëpunojnë me edukatorët 64% e prindërve, që kanë qenë të përfshirë në hulumtim.
 - **Në mënyra të ndryshme sipas nevojës dhe në ditën e dyerve të hapura**, bashkëpunojnë me edukatorët, 6% e prindërve respondentë.
 - **Në mënyra të ndryshme, sipas nevojës dhe në ditën e dyerve të hapura**, janë alternativat e bashkëpunimit me edukatorët që i shfrytëzojnë 9% e prindërve.
 - **Në mënyrë të ndryshme sipas nevojës**
 - **Në ditët e dyerve të hapura dhe**
 - **Bashkëpunimi është në proces**
 - **Gjatë planifikimit dhe realizimit të aktiviteteve** - Këto janë alternativat që i shfrytëzojnë për bashkëpunim 9% e prindërve.
 - **Në mënyra të ndryshme, sipas nevojës,**
 - **Me protokoll, sipas planifikimit dhe**
 - **Bashkëpunimi është në proces, në planifikim dhe realizim të aktiviteteve**, janë alternativat përmes të të cilave bashkëpunojnë me edukatorët 12% e prindërve që ishin pjesë e hulumtimit.

Iniciativat për takime me prindër

Një çështje me rëndësi është edhe fakti se, kush e inicion takimin me prindër ose cili partner i bashkëpunimit ka qasje më optimale për zhvillim të bashkëpunimit edukator-prind. Kjo tregon se, cili faktor është më i gatshëm e më i interesuar për këtë bashkëpunim. Lidhur me këtë, prindërit janë përgjigjur kështu;

- Takimin e iniciojmë ne dhe edukatorja, varësisht nga nevoja, thonë 64% e prindërve
- Bashkëpunimin më shumë e inicion edukatorja, 18% e prindërve
- Bashkëpunimin me prindër e inicion drejtoresha, 18% e prindërve



Grafiku 2. Inicimi i bashkëpunimit me prindër

Shpeshësia e takimit me edukatoren


Në këtë pyetje, 100% e prindërve kanë thënë se ata takohen me edukatoren për çdo ditë. Sigurisht që ata e kanë marrë pyetjen paksa si bukfale, sepse ata fizikisht apo vizualisht, mund të shihen

për çdo ditë me edukatoren, gjatë pranimit-dorëzimit, por jo edhe të kenë takim bashkëpunues e informues rreth fëmijës, sepse kjo do të merrte kohë tepër shumë për edukatoren, e normalisht edhe për prindin. Një takim të tillë të përditshëm, me secilin prind, është e pamundur ta realizojë edukatorja dhe ndoshta edhe është i panevojshëm.

Posedimi i doracakut për „SZhMFH 0-6vjet” nga prindërit

Meqenëse të gjithë edukatorët, që punojnë në institucione parashkollore, kanë ndjekur trajnimin për zbatimin e dokumentit Standardet e Zhvillimit dhe Mësimin të Fëmijërisë së Hershme, në kuadër të tij, është përpiluar edhe udhëzuesi për prindër se si të përdoret ky dokument, i cili është i dedikuar për edukatorë dhe prindër e për këtë arsye, edhe u është bërë kjo pyetje prindërve.

Vetëm 18% e prindërve kanë thënë që e kanë udhëzuesin e 82% as që e kanë parë atë.




Grafiku 3. Posedimi i doracakut për prindër „SZhMFH 0-6vjet

Ata që e posedojnë doracakun, janë shprehur se u ndihmon në disa aspekte, ndër të cilat edhe në qasjen më të mirë reciproke, prind-edukatore.

Përgjegjësi kryesor për bashkëpunim cilësor në favor të fëmijës

Në këtë pyetje, prindërit janë përgjigjur në mënyrë mjaft objektive:


- 36 % kanë thënë që përgjegjës janë prindërit dhe edukatorët.
- 27.5% kanë thënë se përgjegjës janë prindërit, edukatorët dhe menaxhmenti.
- 27.5% kanë thënë se përgjegjës janë vetëm prindërit.
- 9% kanë thënë vetëm edukatorët.



Grafiku 4. Përgjegjësit për bashkëpunim cilësor

Gatishmëria e prindërve për bashkëpunim me edukatoren dhe institucionin parashkollor

Në këtë pyetje, 82 % e prindërve, kanë reflektuar pozitivisht, d.m.th. janë në gjendje për bashkëpunim, kurdo e sido që u kërkohet nga institucioni apo edukatorja. Ndërkaq, vetëm 18%, kanë thënë jo, nuk jemi në gjendje për më shumë bashkëpunim. Pra, sipas këtyre të dhënave, shumica e prindërve, janë gjithnjë të gatshëm, për çdo lloj bashkëpunimi që është në dobi të fëmijës së tij.



Grafiku 5. Koha dhe mundësia e bashkëpunimit

Arsyetimi i prindërve për rëndësinë e këtij bashkëpunimi

Se është i domosdoshëm ky bashkëpunim, kanë deklaruar 100 % e prindërve, kurse pse është i domosdoshëm, i kanë dhënë këto arsye (disa nga komentet e tyre origjinale, ashtu siç kanë reflektuar ata):

- Bashkëpunimi është crucial për zhvillimin e fëmijës dhe për përmbushjen e nevojave edukative dhe argëtuese.

- Bashkëpunimi prind-edukator është i domosdoshëm, në mënyrë që zhvillimi i fëmijës të jetë i monitoruar dhe të kemi mundësi të adaptimit të qasjes sonë sipas situatave aktuale.
- Ne, prindërit, duhet të jemi në kontakt të përditshëm me edukatoren dhe të përcjellim tek ato, çdo detaj rreth fëmijës.
- Pjesëmarrja e prindërve ndihmon zhvillimin më cilësor dhe gjithpërfshirës, sepse në momentet, kur prindi është pjesëmarrës fëmija është më i përmbushur.
- Bashkëpunimi është i rëndësishëm për zhvillimin e fëmijës, sepse mundëson angazhimin e të dy palëve, aty ku ka më shumë nevojë fëmija si dhe mundëson përcjelljen e gjendjes emocionale të fëmijës.
- Bashkëpunimi është i domosdoshëm, për koordinim të aktiviteteve për zhvillimin e nevojshëm të fëmijës.
- Bashkëpunimi është i nevojshëm, sepse fëmija ndihet më i sigurt.
- Bashkëpunimi është i domosdoshëm për zhvillimin e fëmijës, aty ku ka neçje.
- Bashkëpunimi është kusht i domosdoshëm, gjatë procesit të rritjes së fëmijës.

IV. KONKLUSIONE, PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME (të bazuara në rezultatet e dala nga terreni):

Konkluzione

Duke u bazuar në gjetjet e hulumtimit në terren, raporti edukatore-prind, që aplikohet-praktikohet, në institucionet parashkollore (të përcaktuara si mostër), nuk zhvillohet në mënyrën adekuate dhe me qasje të duhur profesionale. Duke qenë i tillë, ky bashkëpunim nuk është as shumë i qëndrueshëm, e të shumtën e rasteve është vetëm formal, rutinor dhe njëkohësisht jo aq me ndikim pozitiv, në zhvillimin e fëmijëve tanë. Kjo është, si pasojë e zbrazësive profesionale, të edukatores, por në anën tjetër është edhe pasojë e mospërgatitjes dhe mosinformimit të prindërve, për rëndësinë e këtij komunikimi-bashkëpunimi. Sepse, ka shumë prindër, që nuk përçojnë deri tek edukatorja, informacione shumë të vlefshme, përmbajtjesore lidhur me zhvillimin dhe gjendjen e përgjithshme të fëmijës. Ata fshehin gjëra shumë të rëndësishme dhe shumë domethënëse, për shëndetin e fëmijëve të tyre, siç janë; epilepsia, autizmi, hiperaktiviteti, ndonjë problematikë e mundshme psiko-fizike, emocionale apo shpirtërore tek personaliteti i fëmijës, pa i ditur pasojat e mëtutjeshme nga kjo. Fshehja apo neglizhimi i këtyre, mund t'i kushtojë shumë fëmijës dhe të ketë pasoja zhvillimore.

Si edukatoret, ashtu edhe prindërit, si duket nuk janë shumë të ndërgjegjshëm, për faktin që niveli i duhur i këtij bashkëpunim, mund të jetë edhe përcaktues i zhvillimit të fëmijës në të ardhmen.

Po ashtu, jo të gjithë respondentët edukatore dhe prindër, e dinë që edhe me Ligjin për Edukimin Parashkollor në Kosovë, është i obligueshëm bashkëpunimi edukatore-prind, në shumë aspekte:

- Në përcjellje të zhvillimit të fëmijës;
- Në përpilim të programit edukativ;
- Në planifikim të punës me fëmijët;
- Në realizim të aktiviteteve me prindër.

Gjatë realizimit të hulumtimit në terren dhe më pastaj, gjatë përpunimit të të dhënave, kemi konstatuar që, në partneritetin edukator-prind, janë evidente disa ngecje, mangësi dhe papërgjegjësi të dyanshme. Së këndejmi, kanë rezultuar si të nevojshme disa rekomandime, të dedikuara për kompetentët e Edukimit Parashkollor, varësisht nga detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, duke filluar nga: MASHT-i, niveli komunal i arsimit, institucioni parashkollor, e deri tek prindi dhe edukatorja.

4.1. Rekomandime të përgjithshme – për MASHT-in

Duke u bazuar në të dhënat e këtij studimi, paraqitet nevoja parësore, që të bëhen hapat e parë, në mënyrë të organizuar dhe efikase, për ngritjen e ndërgjegjësimit të institucioneve dhe prindërve, për një bashkëpunim me institutin parashkollor-edukatoren, në favor të fëmijës. Këtu bëhet fjalë, për iniciativa dhe përpjekje të formave të ndryshme si; trajnime të prindërve, fushata me përmasa gjenerale në nivel lokal dhe në nivel të vendi, të miratuara nga niveli qendror, e të realizuara përmes medieve dhe institucioneve kompetente.

- Me ligj, të fuqizohet dhe të saktësohet, roli i prindit në edukim.
- Të bëhet ngritja e kapaciteteve të menaxhmentit të IP-ve dhe edukatoreve, për një bashkëpunim më profesional e më efikas.
- Të përpilohen strategji për angazhimin e familjes-prindërve në programet e funksionimit të edukimit parashkollor.
- Të forcohet bashkëpunimi me Fakultetin e Edukimit, drejtimin për Edukim Parashkollor, në mënyrë që të forcohen profesionalisht studentët, të cilët në të ardhmen, do të punojnë në IP sepse faktet nga terreni flasin që, një numër jo i vogël edukatoresh, kanë vështirësi dhe mangësi në kryerjen e detyrave të tyre kyçe dhe kanë nevojë të dinë më shumë në këto aspekte; psikologji të fëmijëve, planifikim të aktiviteteve, në kreativitetin për lojëra, në improvizim e përshtatje të mjeteve të punës, në bashkëpunim me prindër, etj., gjë që reflektohet drejtpërdrejt, në trajtimin e fëmijëve, gjatë punës së tyre.
- Si pjesë të programit të kualifikimit të edukatorëve, të jenë të përfshira edhe module për bashkëpunimin me prindër.
- Të përpilohet një udhëzim, i cili më konkretisht, mundëson informimin e edukatorëve dhe të prindërve, për detyrat e tyre të përcaktuara me ligjin për parashkollor.
- Të krijohet një manual për prindër, në mënyrë që të vetëdijesohen ata, se si të jenë më bashkëpunues me

edukatorët dhe IP-në dhe si ta trajtojnë fëmijën e tyre, në mënyrën më të mirë.

- Të përkrahet profesionalisht më shumë, niveli lokal për parashkollor. (Kjo mundëson shtimin e përgjegjësive dhe ndërgjegjësimin e DKA-ve për këtë nivel edukimi, sepse nga shumë zyra komunale të arsimit, ky nivel edukimi anashkalohet ose neglizhohet. Për këtë arsye, në disa komuna, ka pak institucione parashkollore e në disa nuk ka fare. Kjo reflekton shumë negativisht tek fëmija, familja, komuniteti dhe shoqëria përgjithësisht, kur dihet që edukimi parashkollor ka rol vendimtar për formimin e personalitetit të fëmijës dhe është fundamental, për arsimimin e mëtutjeshëm të tij)
- Të sigurohet këshillim profesional, informim i mirëfilltë i edukatoreve, lidhur me qasjen ndaj prindërve, mënyrën e bashkëpunimit dhe rëndësinë e pakontestueshme të këtij bashkëpunimi.
- Të jepen alternativa të teksteve për përdorim, sepse ka shumë mungesa dhe konfuzitet nga ana e IP-ve dhe edukatorëve, në përcaktimin e literaturës për parashkollor.
- MASH-T-DKA-të, si normë në standardin e vlerësimit të performancës së edukatorëve, ta kenë edhe mënyrën e bashkëpunimit me prindër (si pjesë e obligueshme e punës së tyre).

4.2. Rekomandim për Fakultetin e Edukimit

- Fakulteti i Edukimit, drejtimi i Edukimit Parashkollor, në programin për kualifikim të edukatorëve, të përfshijë edhe

bashkëpunimin edukator-prind, në formë semestri apo kapitulli semestral në mënyrë që edukatoret e ardhshme, të dinë të kenë qasje më profesionale ndaj prindërve.

4.3. Rekomandimet për IP

- IP, në bashkëpunim me DKA-në dhe MASHT-in, duhet të gjejë mundësinë e përpilimit të strategjive të ndryshme, për ta kyçur prindin në bashkëpunim me institucionin parashkollor dhe shkollën.
- Të rishikohen mundësitë e sigurimit të mënyrave dhe të vendeve (hapësirave në kuadër të IP-së), më të përshtatshme dhe të përhershme të mbajtjes së sesioneve me prindër.
- Bashkëpunimi me prindër, të trajtohet me seriozitet nga i tërë Institucioni Parashkollor (nga drejtori, bordi i IP-së dhe edukatorja), sepse ky bashkëpunim është faktor me rëndësi edhe për edukimin e prindërve në qasjen e duhur ndaj fëmijës së tyre.
- Të kërkohen dhe të sigurohen resurse profesionale, për ngritjen e kapaciteteve të prindërve bashkëpunues, përmes të të cilëve do të realizohen tema që do të ndikojnë drejtpërdrejtë në qasjen e tyre ndaj fëmijëve, në shtëpi. (P.sh. të tilla tema mund të jenë; Zhvillimi i gjithanshëm i fëmijës, Psikologjia e fëmijës, Shëndeti fizik dhe emocional i fëmijës, Ushqimi i shëndetshëm i tij, Xhelozia dhe egoizmi te fëmijët, etj.).
- Të mbahen mbledhjet periodike të prindërve në ambientin e kopshtit, ku bashkëbisedohet për tema të përgjithshme

rreth ngecjeve dhe përparësive në funksionimin e punës në IP.

- Realizimi i takimeve të veçanta me prindër (këto takime nuk d.m.th. që marrin shumë kohë. Ato, nëse planifikohen mirë nga edukatorja, mund të jenë spontane e të përditshme dhe nëse janë të realizuara dhe të orientuara me profesionalizëm, janë takimet më të efektshme dhe që ndikojnë shumë në ecurinë e mbarë të zhvillimit të fëmijës).
- Bordi i institucionit parashkollor, në bashkëpunim me drejtorin, duhet të fuqizojë mekanizmat e brendshëm, rregulloret, kodet etj., dhe përmes tyre të funksionalizojë edhe bashkëpunimin me prindër duke përcaktuar temat, çështjet dhe pikat e bashkëpunimit (përpilimi i planit të punës, planifikimi i aktiviteteve, realizimi i aktiviteteve, plani i vëzhgimit të zhvillimit të fëmijës, etj).
- Përmbajtja e temave, sesioneve, të përshtatet me nivelin e emancipimit dhe edukimit të pjesëmarrësve-prindërve, si dhe t'i përshtatet kontekstit, specifikave të komunitetit dhe nevojave të tyre.
- Të shfrytëzohet roli i pedagogut të institucioneve parashkollore edhe për profesionalizimin e bashkëpunimit edukator-prind.

4.4. Rekomandime - këshilla për edukatorë:

- Të kenë qasje më profesionale ndaj bashkëpunimit me prindër

- Të jenë të vetëdijshme që bashkëpunimi me prindin, ka qëllimin fundamental: zhvillimin më të plotë e më të gjithanshëm të fëmijës.
- Të gjejnë mënyrën e përshtatshme dhe momentin e duhur që të komunikojnë me prindërit (sepse një pjesë e tyre, ngurojnë të komunikojnë lirshëm me edukatoren).
- Të bëjnë përpjekje për krijimin e besimit reciprok me prindërit, në mënyrë që ata të ndihen më konfident, për informatat që japin lidhur me fëmijët e tyre.
- Të mbahet komunikim i vazhdueshëm me prindërit-familjen.
- Komunikimi me prindër, të jetë i mirëfilltë, efektiv dhe si objektiv ta ketë, zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës (sepse shpesh në kopsht dhe në shtëpi, fëmija të shumtën vëzhgohet vetëm nga aspekti fizik i tij; a han, a flenë mirë, etj.).
- Të informohen prindërit, lidhur me planin edukativ të aktiviteve.
- Të informohen prindërit për aktivitetet e realizuara me fëmijët (përmes ekspozimeve të punimeve të tyre dhe alternativave të tjera të ndryshme, me anë të të cilave, prindërit informohen për punën e edukatores, për zhvillimin, gjegjësisht aftësimin e fëmijëve, apo për ndonjë ngecje eventuale të tyre).
- Të koordinojnë së bashku me prindërit, më shumë projekte dhe aktivitete.

- Të aplikohet edhe alternativa e komunikimit me shkrim, me prindërit (sidomos në fillim të vitit, gjatë fazës së adaptimit, në fillim të njohjes me fëmijën dhe prindin), sepse kështu, ata shprehen më lirshëm e më lehtë, për gjithçka, lidhur me fëmijën e tyre. (Kjo mënyrë është praktike dhe më ekonomike, në mungesë të kohës dhe mundësisë).
- Të shfrytëzohen takimet e përditshme me prindër, gjatë pranimit-dorëzimit, për një komunikim më esencial rreth zhvillimit të fëmijës.
- Të bëhet përpjekje, që në institucion parashkollor, të mundësohen takime prind-ekspert, të fushës së zhvillimit të fëmijërisë së hershme dhe të trajtohen tema, që prindërve ju interesojnë dhe këto të realizohen, në kohën që edhe atyre ju përshtatet.
- Takimi me prindër të bëhet duke iu përshtatur veçorive të fëmijës, por edhe të prindit.
- Të ndërmerret gjithçka, që kur prindi vjen në IP, të ndjehet i mirëpritur.

4.5. Rekomandime-këshilla për prindër

- Prindi të jetë i ndërgjegjshëm se ai është përgjegjësi i parë e kryesor për zhvillimin dhe edukimin e fëmijës.
- Ta njoftojë pa ngurrim e sinqerisht edukatoren lidhur me fëmijën, si për arritjet, ashtu edhe për ngeçjet e tij. (Kjo është në dobi të vet fëmijës, pasi që kur edukatorja është e informuar mjaftueshëm për të, di ta orientojë më mirë

trajtimin dhe angazhimin e tij, në mënyrë të drejtë dhe adekuate, aty ku ai ka nevojë).

- Të zbatojë komunikim të mirëfilltë, përveç me edukatoren edhe me prindër të fëmijëve të tjerë nga IP, në mënyrë që të këmbejë njohuri e përvoja, në dobi të lojës dhe rritjes së shëndetshme të fëmijës.
- Të mos i merr për të keq dhe të mos e mbrojtë fëmijën, në rast se edukatorja shpreh vërejtjet, apo ndonjë ves të tij, sepse bashkëpunimi, mundëson edhe eliminimin e tyre.
- Të tregojë pjekuri e gatishmëri për bashkëpunim, jo vetëm në mënyrë materiale apo teknike, siç ndodhë në të shumtën e rasteve tek ne, duke ofruar përkrahje kur paraqitet nevoja apo edhe në mënyrë vullnetare (në aspektin financiar, në mjete teknike për transport, në aktivitete-lojëra, për organizimin e programeve për fëmijë, etj.). Prindi duhet të tregojë gatishmëri edhe për komunikim përmbajtjesor-edukativ me edukatoren, të konsultohet me të se si ta trajtojë, e ta angazhojë fëmijën e vet në shtëpi, në mënyrë që të ndikojë, aty ku ai ka nevojë më shumë.

Përfundim

Edhe pse bashkëpunimi edukator-prind është një problematikë permanente, që e përcjell edukimin parashkollor te ne për një kohë të gjatë, edhe sot e kësaj dite vazhdon të jetë një problem pothuajse i patrajtuar me seriozitet nga kompetentët. Duke mos u trajtuar dhe duke mos u zbatuar si duhet, ky bashkëpunim, ende

është mjaft rutinor, jo përmbajtjesor dhe shpesh edhe jo adekuat. Si i tillë, është jo efektiv dhe i padobishëm, për zhvillimin e gjithanshëm e të suksesshëm të fëmijës.

Prandaj, edhe synim i këtij hulumtimi është, që të ndikojë në funksionalizimin e një partneriteti të qëndrueshëm, në mënyrë që të sigurohet një kujdes më i mirë, një qasje më profesionale ndaj fëmijës nga të dy palët.

Krijimi i një raporti më profesional dhe më të sinqertë mes këtyre dy partnerëve (edukatorëve dhe prindërve), mundëson formimin e një edukatoreje më cilësore, më vëzhguese ndaj fëmijës, gjegjësisht zhvillimit të tij, e njëkohësisht edhe motivimin e prindit, që të jetë më mbështetës ndaj fëmijës së tij dhe më kontributdhënës, ndaj punës dhe aktiviteteve të edukatores. Vetëm si i tillë, ky bashkëpunim, është i suksesshëm dhe reflekton shumë dobishëm te fëmija si objektivë e të dy palëve.

Burimet

1. Brada, Riza (1995) Pedagogjia Familjare, Pejë.
2. Deva-Zuna, Afërdita & bashkëpunëtorët (2009) Partneriteti shkollë-familje-komunitet, Prishtinë.
3. Deva-Zuna, Afërdita (2003) Edukimi i parashkollorit në familje, Prishtinë
4. Hoxha Cekani, Ermioni (2010) Botimi i tretë, Libri i mësueses së arsimit parashkollor, Botimet Polis.
5. KEDP, (2005) Libri me udhëzime për situatat me nxënësin në qendër, Botimi i III.
6. Kulinxha, Ganimete, (2015) Komunikimi ndërpersonal në fëmijërinë e hershme sipas programit me fëmijën në qendër Prishtinë,
7. Ligji për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës –Nr.03/L-068 2008
8. Ligji për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032
9. Ligji për Edukimim Parashkollor në Republikën e Kosovës- UNMIK/REG.2006/11
10. Mato, Dr. Erlehta & Dr. Pranvera Kamani, (2002) Në kërkim të njohjes-Pedagogjia e projektit edukativ, UNICEF Tiranë.
11. Miller, Bonnie (2007) Si të krijohet kontakti i suksesshëm me nxënësit”, QPEA

12. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijëri të hershme 0-6 vjet, Tetor 2011,
13. Montesori, Maria (2009) Zbulimi i fëmijës, Manual i pedagogjisë shkencore për kopshtet dhe shkollën fillore, Plejad.
14. Save the children (2012) Fëmijët e lumtur ju bëjnë prindër të lumtur. Ju mund t'ia dilni- Udhëzues për të qenë prind i suksesshëm i një fëmije parashkollor, Tiranë.
15. Selmani, Lefteri & Aurela Zisi (2006), Konceptimi dhe organizimi i veprimtarisë mësimore - edukative në arsimin parashkollor, GEER.
16. Vadahi, Fatmir (2002) Pedagogjia parashkollore, Shkodër.

Burime nga interneti:

<http://www.more4kids.info>

<http://www.harvardhomemaker.com>

<http://www.parents.com>

<http://www.scholastic.com>

<http://creativewithkids.com>

V- SHTOJCA;



PYETËSOR PËR EDUKATORE

Të nderuara edukatore, në IP-të tona, shumë shpesh, është i shprehur si problem shqetësues dhe delikat, bashkëpunimi me prindër, prandaj, po e realizojmë këtë pyetësor, në IP publike e private, me qëllim të marrjes së informatave reale nga terreni lidhur me format e bashkëpunimit edukator-prind, që realizohen në praktikën tuaj të punës në institucione. Ju lusim që secilën pyetje ta lexoni me kujdes, dhe të përgjigjeni në mënyrë sa më reale. Saktësia dhe sinqeriteti juaj, do të na ndihmojë shumë, në paraqitjen e të dhënave faktike dhe do të na mundësojë që të dalim me rekomandime sa më adekuate për ju .

I. Të dhënat e përgjithshme

Vendos shenjen “X” në katorrin që paraqet përgjigjen e saktë

1. Gjinia: Femër Mashkull

2. Moshë: 21-30 vjet 31-40 vjet 41-50 vjet

51-60 vjet Mbi 60 vjet

3. Përgatitja shkollore:

- Magjistër Master Fakulteti
 SHLP Shkollë e mesme

4. Përvoja e punës në IP

- 0-1 vjet 2-5 vjet 6-10 vjet
 11-20 vjet Mbi 20 vjet

5. Përfshirja në trajnime, shëno programet e trajnimit që keni ndjekur:

Rretho më shumë se një përgjigje nëse është e nevojshme.

- Hap pas hapi
 Regjio Emilio
 Fëmija në qendër
 Szhmfh
 Majeutika
 Tjetër program trajnimi - praktik profesional dhe specifik

6- Bashkëpunimi me prindër është :

- a)- Shumë i mirë
b)-I mirë
c)-Jo i mirë

7- Si i merrni informatat nga prindërit, lidhur me fëmijët ?

	Çdoherë	Shpesh	Disa herë	Asnjëherë
Prindit i bëj pyetje të përgjithshme për fëmijën	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Shtroj pyetje specifike lidhur me zhvillimin individual të fëmijës.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Vëzhgoj-përcjell fëmijët gjatë gjithë kohës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
E vlerësoj përfshirjen e fëmijëve në aktivitete, dhe ia përcjell prindit informatat lidhur me këto	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Punoj me fëmijët duke u konsultuar me prindërit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Reciprokisht ndihmojmë njëri-tjetrin në zhvillimin e përgjithshëm të fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

8- Si e menaxhoni bashkëpunimin me prindërit e fëmijëve ?

	Çdo herë	shpesh	Nganjë herë	rrallë	tjetër
Planin e punës e bëj në bashkëpunim me prindërit.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Prindërit marrin pjesë, ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve					
Përdori mënyra alternative të bashkëpunimit me prindërit, varësisht nga nevojat e fëmijëve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Me prindërit kam takime informuese të përditshme, gjatë pranimit-dorëzimit të fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Kam takime të përgjithshme sipas protokollit dhe planifikimit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Planin e aktiviteteve për grupin e vendosi në tabelën e informatave	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Me prindërit komunikoj dhe i informoj përmes telefonit	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Prindërit i informoj për gjithçka rreth fëmijës, me e-mail.	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Takohem me prindërit varësisht nga nevojat dhe kërkesat e tyre	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
Nuk kemi bashkëpunime të frytshme, sepse ata nuk kanë interesim të duhur	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

Shkruaj me fjalë, ndonjë mënyrë tjetër të bashkëpunimit që ju e zbatoni:

9- Me cilët prindër keni bashkëpunime me efikase?

Rretho vetëm një përgjigje

- Me prindërit më të emancipuar (të ngritur)
- Me prindërit e fëmijëve më të avancuar
- Me prindërit e fëmijëve më me ngecje
- Me prindërit që nuk punojnë
- Me prindërit e fëmijëve me nevoja të veçanta

10- Kush inicion takimet me prindër?

Rretho vetëm një përgjigje

- Çdo herë prindërit
- Të shumtën e herëve prindërit
- Prindërit dhe edukatorët bashkërisht
- Të shumtën e herëve edukatorët
- Drejtoresha

11- Sa shpesh takoheni me prindërit dhe diskutoni rreth fëmijës?

(Rretho vetëm një përgjigje)

- Çdo ditë (gjatë pranimit-dorëzimit të fëmijës)
- Çdo javë
- Çdo muaj
- Sipas nevojës
- Shumë rrallë
- Vetëm kur kemi programe festive me fëmijët
- Sipas planit për bashkëpunim me prindër

12- Si bashkëpunoni me prindërit e fëmijëve me zhvillime specifike?

Rretho më shumë përgjigje nëse është e nevojshme

- Përmes takimeve të rregullta
- Sipas nevojave të fëmijës
- Sipas preferencave të mjekut special
- Tjetër (shëno):

.....

12. A e praktikoni ditën e dyerve të hapura për prindërit ?

- Po Jo

Nëse Po, sa frekuentojnë prindërit atë ditë?

- Shumë Pak Aspak

13. Dokumenti – Standardet e Zhvillimit dhe Mësimit të Fëmijërisë së Hershme ju ka ndihmuar në përmirësimin e bashkëpunimit me prindër në këto aspekte

	Çdoherë	Shpesh	Disa herë	Asnjëherë
Në pjesëmarrjen e prindërve në planifikim të aktiviteteve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Në identifikimin e arritjeve dhe ngecjeve të fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Në realizimin e aktiviteteve të planifikuara	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Në përmbushjen e nevojave individuale të fëmijës	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
Në organizimin e programeve	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>

14. Cilat janë komentet e sugjerimet tuaja lidhur me bashkëpunimin sa më efikas me prindërit?

.....

.....

.....

.....

Ju faleminderit për bashkëpunimin!

Të nderuar prindër,

Gjatë bashkëpunimit profesional që kemi pasur me të gjitha Institucionet Parashkollore Publike në Kosovë, pothuajse në të gjitha këto, janë paraqitur vërejtje e pakënaqësi për bashkëpunimin edukator –prind. Prandaj, Instituti Pedagogjik i Kosovës në mirëkuptim edhe me MASHT-in, e kanë parë të nevojshme, që të realizojnë një hulumtim, i cili do të mundësojë paraqitjen e gjendjes reale lidhur me këtë çështje, si dhe evidentimin e mënyrave të bashkëpunimit, të cilat funksionojnë në praktikën e Institucioneve tona Parashkollore.

Ky hulumtim, përveç që do të shërbejë për të parë gjendjen faktike të bashkëpunimit edukator-prind, do të jetë edhe si mbështetje dhe si pikënisje në përpjekjet tona, për ta forcuar dhe profesionalizuar këtë bashkëpunim, i cili është kyç, për zhvillimin më cilësor të fëmijëve tuaj.

Komuna: _____

Institucioni Parashkollor ku e keni fëmijën

Profesioni-pozita ku punoni:

Pyetësor	
Komuna _____	
P.1	Bashkëpunimi juaj me edukatoren është :
1	Shumë i mire-- <input type="checkbox"/> I mire ----- <input type="checkbox"/> Jo i mire----- <input type="checkbox"/>
P.2	Si informoheni rreth qëndrimit dhe zhvillimit të fëmijës tuaj në Institucionin Parashkollor?
1	Çdo ditë i bëj pyetje edukatores rreth zhvillimit të përgjithshëm të fëmijës ----- <input type="checkbox"/> Sipas nevojës, edukatores i bëj pyetje specifike lidhur me zhvillimin individual të fëmijës----- <input type="checkbox"/> Takohemii me edukatoren kur ajo ju kërkon që të më informojë lidhur me fëmijën tim----- <input type="checkbox"/> Reciprokisht informohemi për gjithçka rreth zhvillimit të fëmijës ----- <input type="checkbox"/>
P.3	Si e realizoni bashkëpunimin me edukatoren ?
1	Bisedat-takimet me edukatoren i realizojmë në mënyra të ndryshme,sipas nevojës----- <input type="checkbox"/> Takimet me edukatoren i kemi me protokoll, sipas planifikimit----- <input type="checkbox"/> Për t'u informuar rreth fëmijës, me edukatoren zakonisht komunikoj me telefon----- <input type="checkbox"/> Me edukatoren më shumë bashkëpunoj përmes emaili----- <input type="checkbox"/>

	<p>Bashkëpunimin me edukatoren e kemi si proces, ku ne angazhohemi edhe në planifikimin edhe në realizim e aktiviteteve e projekteve të ndryshme----- <input type="checkbox"/></p> <p>Nuk kemi bashkëpunim sepse edukatorja është e pa interesuar për këtë.-----<input type="checkbox"/></p>
P.4	Kush e inicion bashkëpunimin me prindërit?
1	<p>Prindërit-----<input type="checkbox"/></p> <p>Prindërit dhe edukatorja, varësisht nga nevoja-----<input type="checkbox"/></p> <p>Edukatorja ---- <input type="checkbox"/></p> <p>Drejtoresha-----<input type="checkbox"/></p>
P.5	Sa shpesh takoheni me edukatoren?
1	<p>Çdo ditë, gjatë pranimit dorëzimit -----<input type="checkbox"/></p> <p>Çdo javë -----<input type="checkbox"/></p> <p>Çdo muaj -----<input type="checkbox"/></p> <p>Shumë rrallë -----<input type="checkbox"/></p> <p>Vetëm kur ka ndonjë projekt bashkëpunimi apo programe festive -----<input type="checkbox"/></p>
P.6	A e keni doracakun për prindër „Standardet e Zhvillimit në Fëmijërinë e Hershme”?
1	Po <input type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/>
P.7	Nëse po, a ju ka ndihmuar në bashkëpunimin me edukatoren në favor të qasjes më adekuate të kujdesit ndaj fëmijës?
1	Në pjesëmarrjen e prindërve në planifikim të aktiviteteve ----- <input type="checkbox"/>

	<p>Në identifikimin e arritjeve dhe ngecjeve të fëmijës ---□</p> <p>Në realizimin e aktiviteteve të planifikuara -----□</p> <p>Në përmbushjen e nevojave individuale të fëmijës ----□</p> <p>Në qasjen më adekuate ndaj bashkëpunimit me edukatoren dhe ndaj fëmijës -----□</p>
P.8	Për bashkëpunim më cilësor e në favor të fëmijës kush mendoni se është më përgjegjës?
1	<p>Prindërit -----□</p> <p>Edukatoret -----□</p> <p>Menaxhmenti i Institucionit Parashkollor -----□</p>
P.9	Sa është, sipas jush, i rëndësishëm bashkëpunimi prind-edukator?
1	<p>Jepni shkurtimisht mendimin tuaj lidhur me këtë:</p> <p>-----</p> <p>-----</p>
P.10	Cila mendoni që është mënyra më e mire dhe më efikase e bashkëpunimit prind-edukatore?
1	<p>Shkruaj një fjali ose më shumë për mënyrat e bashkëpunimit prind-edukatore, të cilat ndikojnë në zhvillimin më cilësor dhe më të gjithanshëm të fëmijës tuaj:</p> <p>-----</p> <p>-----</p> <p>-----</p>

Botues

Instituti Pedagogjik i Kosovës

Shtypi

Shtypshkronja “Blendi” Prishtinë

Tirazhi: 500 copë

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

373.2(496.51)(047)

37.064.1(496.51)(047)

Plakolli, Zehrie

Bashkëpunimi edukatore - prind në institucionet parashkollore të Kosovës / Zehrie Plakolli, Mevlude Aliu-Gashi. - Prishtinë : Instituti Pedagogjik i Kosovës, 2016. – 83 f. : ilustr. me ngjyra; 21 cm.

Burimet : f. 70-71

1. Aliu-Gashi, Mevlude

ISBN 978-9951-591-39-3



ISBN 978-9951-591-39-3



9 789951 591393



ISBN 978-9951-591-39-3



9 789951 591393